



ALBANIAN ASSOCIATION OF BANKS  
SHOQATA SHQIPTARE E BANKAVE

# Bankieri


Botim i Shoqatës Shqiptare të Bankave

Nr. 9 Tetor 2013

ISSN 2225-2959



9 772225 295004




**STABILITETI FINANCIAR**  
*Gjithnjë i rëndësishëm*



# 1, 2, 3...

## DERRKUCI ÇUFO MËSON TË KURSEJË



**Shoqata Shqiptare e Bankave  
bashkëpunon përsëri me Bankën e Shqipërisë  
për printimin e paketës së re mësimore dedikuar edukimit financiar  
të nxënësve që ndjekin klasën I, II dhe III të shkollës 9-vjeçare.**



# Përmbajtja

## EDITORIAL

Stabiliteti financiar - Gjithnjë i rëndësishëm  
nga Elvin MEKA

f.5

## TEMA E DITËS

Stabiliteti financiar – Një objektiv i përhershëm  
nga Klodion SHEHU

f.6

Bankat takohen me Kryeministrin e ri – Një tryezë  
shumë e rëndësishme

f.8

Qëndrueshmëri financiare dhe rritje ekonomike:  
Një binom?! nga Sulo HADËRI

f.9

## KËNDI I GAZETARIT

Interesat, buxheti i shtetit dhe ekonomia - "I miri, i keqi  
dhe i shëmtuari" nga Gjergj EREBARA

f.11

## INTERVISTA

Union Bank – Një filozofi bankingu me gjashtë shtylla  
Intervistë me Gazmend KADRIU

f.13

## SISTEMI BANKAR

Përballja me stanjacionin ekonomik  
nga Kaan PEKIN

f.14

Banka Depozitare – Partner për një menaxhim  
gjithëpërfshirës të fondeve të pensioneve dhe atyre të  
investimeve nga Elma LLOJA

f.17

## FORUMI I EKSPERTËVE

Zgjidhja e çështjes së huave me probleme në Mal të Zi  
nga Nebojša ĐOKOVIC

f.19

Partneritetet Publik-Privat (PPP) dhe Raportimi Financiar  
nga Hysen ÇELA dhe Kledi KODRA

f.23

## KËNDI I EKONOMISTIT

Masat makro-prudenciale dhe stabiliteti financiar, nën  
optikën e Bazel III nga Adrian CIVICI

f.26

## PËRGJEGJSHMËRIA SOCIALE

Aktivitete nga Bankat

f.30

Junior Achievement of Albania

f.35

## RRJETI BALLKANIK

Lajme ndërballkanike

f.36

## TEKNOLOGJI

Winbank - gjithçka në një kuti  
nga Frida KRIFCA

f.39

## AUDITORI FINANCIAR

Titullizimi – Një mekanizëm revolucionar për menaxhimin  
dhe transferimin e rrezikut

f.42



BANKIERI është publikimi zyrtar  
i Shoqatës Shqiptare të Bankave  
i cili i dedikohet kryesisht sektorit  
bankar shqiptar. BANKIERI i  
jep lexuesit një informacion të  
vlefshëm mbi arritjet e industrisë  
në përgjithësi dhe të bankave  
tregtare në veçanti.

## Bankieri

Nr. 9, Tetor 2013

Botim i Shoqatës Shqiptare të Bankave

## Redaksia:

Elvin Meka

**Kryeredaktor**

Junida Tafaj (Katroshti)

**Koordinatorë Produksioni**

Anduena Manushi

**Redaktore**

Gert Hoxha

**Fotograf**

**Design & Layout:** Ladybird Creations

**Shtypi:**  Gentigrafik

## Bordi Editorial:

Seyhan PENCABLIGIL

Kryetar i AAB-së & Drejtor i Përgjithshëm i  
Banka Kombëtare Tregtare

Ioannis KOUGIONAS

Nënkryetar i AAB-së & Drejtor i Përgjithshëm i  
NBG Bank Shqipëri

Christian CANACARIS

Anëtar i Bordit Drejtues të AAB-së & Drejtor i Përgjithshëm i  
Raiffeisen Bank Shqipëri

Periklis DROUGKAS

Anëtar i Bordit Drejtues të AAB-së & Drejtor i Përgjithshëm i  
Alpha Bank Shqipëri

Frédéric BLANC

Anëtar i Bordit Drejtues të AAB-së & Drejtor i Përgjithshëm i  
Societe Generale Shqipëri

Bozhidar TODOROV

Anëtar i Bordit Drejtues të AAB-së & Drejtor i Përgjithshëm i  
Fibank Shqipëri

Endri XHAFAERAJ

Sekretare e Përgjithshme, Shoqata Shqiptare e Bankave

Hysen ÇELA

Kryetar i Institutit të Ekspertëve Kontabël të Autorizuar

Adrian CIVICI

President & Drejtor i Shkollës Doktorale

Universiteti European i Tiranës

Spiro BRUMBULLI

Drejtor i Kabinetit të Ministrisë të Financave

Enkeleda SHEHI

Kryetare e Autoritetit të Mbikqyrjes Financiare

SHOQATA SHQIPTARE E BANKAVE

Bulevardi: "Dëshmorët e Kombit", KULLAT BINJAKE

Kulla I, Kati 6-të, A3, Tiranë

Tel: +355 4 2280 371; Fax: +355 4 2280 359

E-mail: bankieri@aab-dl.org; www.aab-dl

KREDI PËR RINOVIM

**Rinovo tani shtëpinë tënde!**



**Kredi për rinovimin e shtëpisë me interes të ulët**



**NBG Bank**  
Tradicionalisht e besueshme

## STABILITETI FINANCIAR – GJITHNJË I RËNDËSISHËM



nga **Dr. Elvin MEKA**<sup>1</sup>  
Kryeredaktor

Sot stabiliteti i sistemit financiar kombëtar është pjesë integrale e stabilitetit të sistemit financiar global, pavarësisht nga faza e zhvillimit dhe thellësia e çdo sistemi financiar në botë. Një realitet i tillë e bën stabilitetin financiar gjithnjë të rëndësishëm e të domosdoshëm, kudo në botë.

Në vitin 2002, z. Dean LeBaron dhe z. Romesh Vaitilingam shkruanin, ndër të tjera, në librin e tyre të famshëm: “*Thesari i Mençurisë së Investimit – 30 Mendjet më të Ndritura të Investimit*”, në kapitullin përmbyllës: “*future focus II: ten key global issues*”:

...Një nga karakteristikat thelbësore të kësaj epoke është shkalla e lartë e ndërlidhjes që po përjetojmë – ndërlidhje kjo në nivele personale, biznesi dhe qeveritare. Tashmë jemi në gjendje, si asnjëherë tjetër më parë, të lidhim apo bëjmë bashkë thujse gjithshka...Ndërlidhja financiare në rang global nuk ka qenë asnjëherë në një nivel si ky i sotmi. Tani kemi një sistem të përbashkët bankar, ku paraja ka mundësi të qarkullojë, në çast, në rrugë elektronike dhe në sasi të pakufizuara, në të katër anët e globit, pa asnjë lloj transparence. ...Por kur një nga lojtarët globalë ka probleme, qoftë kjo Korea, Indonezia, Rusia apo Brazili, pjesa tjetër e mendon me të drejtë se, duhet zbatuar një paketë shpëtimi me çdo çmim. Kjo është sikur të kemi një pacient që mund të vuajë nga një sëmundje ngjitëse. Pavarësisht nga kjo, duket se e vetmja mënyrë për ta ndaluar atë është që ta lemë të lirë pacientin mes njerëzve. Normalisht, një pacient i tillë trajtohet duke e mbajtur në karantinë”.

Kjo duket si një sinjal i hershëm paralajmërues, lidhur me shpërthimin e krizës së fundit financiare të viteve 2007-2008. Kjo krizë solli në qendër të vëmendjes çështjen e nxehtë të stabilitetit financiar, nisur nga “cunami” financiar, që shkaktoi shkërmoqja e Lehman Brothers, në sistemin financiar ndërkombëtar. Kriza shpalosi dimensionin e jashtëzakonshëm të ndërlidhjes ndërkombëtare, si dhe çimentoi faktin se menaxhimi i rreziqeve të ndryshme nuk përbënte më një çështje brenda kufijve kombëtarë, por ajo tashmë është fenomen global. Sot stabiliteti i sistemit financiar kombëtar është pjesë integrale e stabilitetit të sistemit financiar global, pavarësisht nga faza e zhvillimit dhe thellësia e çdo sistemi financiar në botë. Një realitet i

tillë e bën stabilitetin financiar gjithnjë të rëndësishëm e të domosdoshëm, kudo në botë.

Në morinë e rreziqeve me të cilat përballet sistemi financiar shqiptar, rreziku sistemik është nga më dominuesit, nisur nga shkalla shumë e madhe e ndërmjetësimit bankar dhe mungesa e tregut të letrave me vlerë (aksioneve, obligacioneve) në Shqipëri. Rëndësia e këtij lloji rreziku bëhet gjithnjë e më e qartë në periudha krize, në vendet me ekonomi që mbështeten fuqishëm në ndërmjetësimin bankar, kështu që mund të themi se për sistemin tonë bankar ai është bërë një fenomen endemik. Sistemi bankar në Shqipëri, duke qenë ofruesi thujse unik i huave dhe financimit (të jashtëm) për bizneset, ka magnetizuar dhe tërhequr brenda vetes gati të gjitha rreziqet në ekonomi, të cilët peshojnë konsiderueshëm në bilancet e bankave. Deri më tani, sistemi bankar ka qenë i suksesshëm në minimizimin e elementëve më të spikatur të rrezikut sistemik, si: kriza e likuiditetit, pamjaftueshmëria e kapitalit dhe përdorimi i tepruar i efektit të levës. Gjithashtu, Banka e Shqipërisë ka luajtur rol kyç në zbatimin e disa masave kundërciklike, si pjesë e mbikëqyrjes makro-prudenciale.

Megjithatë, minimizimi i peshës dhe rolit të elementëve të mësipërm nuk nënkupton një pakësim automatik e të drejtpërdrejtë të rrezikut sistemik brenda sistemit bankar. Zvogëlimi i përdorimit të levës nuk është një opsion për sistemin bankar shqiptar, duke pasur parasysh nivelin aktual të saj dhe modelin bankar që përdoret në vend; ekzekutimi i kolateralit, gjithashtu, është një proces mjaft kompleks dhe kohëkonsumues. Rrjedhimisht, grupet e interesit, përfshirë këtu dhe autoritetet rregullatore, mund të konsiderojë zgjidhje të tjera, të cilat synojnë zhvillimin e një sistemi të ekuilibruar financiar, thellimin e tij, si dhe transparencë më të madhe financiare nga pjesëmarrësit e tregut.

<sup>1</sup> Përgjegjës i Departamentit të Financës, UET

## STABILITETI FINANCIAR – Një objektiv i përhershëm



**nga Z. Klodion SHEHU**  
Drejtor i Departamentit  
të Stabilitetit Financiar  
Banka e Shqipërisë

Kriza globale financiare e vitit 2008, theksoi më tej rëndësinë e qëndrueshmërisë së sistemit financiar. Ruajtja e stabilitetit financiar nënkupton nevojën për vlerësimin dhe kufizimin e rrezikut sistemik, ose të rrezikut që sistemi financiar në tërësi të humbasë, pjesërisht ose plotësisht, aftësinë e tij për të ofruar shërbimet financiare, duke ndikuar negativisht në veprimtarinë e agjentëve ekonomikë dhe ekonominë në përgjithësi. Vlerësimi i rrezikut sistemik për sistemin financiar përfaqëson një objektiv të vështirë, për shkak të disa karakteristikave të sistemit financiar, që lidhen me prirjen e tij: a) për të zmadhuar efektin e goditjeve të ndryshme ekonomike; b) për t'u bërë pjesë e një mekanizmi që vetushqen rritjen e ekspozimeve ndaj rreziqeve; dhe c) për të hyrë në lidhje financiare komplekse, që rrisin ndjeshmërinë e sistemit ndaj goditjeve të ndryshme. Për shembull, ngadalësimi i ekonomisë mund të përshkallëzohet më tej nëse sistemi financiar ose sektori bankar zgjedhin të ndjekin politika më të shtrënguara të huadhënies. Ose, lidhja e drejtë mes huadhënies dhe vlerës së pasurive të paluajtshme (që shërbejnë shpesh si kolateral për huat), rrezikon të nxisë një rritje të ekspozimit të sistemit fi-

nciar ndaj rrezikut të një flluske të mundshme në tregun e pasurive të paluajtshme. Lidhjet financiare të vendosura nga sistemi financiar nuk janë vetëm të drejtpërdrejta e të dukshme, por mund të jenë edhe në formën e garancive të fshehura, ose të ekspozimit në tregjet e derivative. Ndaj, madhësia e ekspozimit të sistemit financiar ndaj rreziqeve dhe humbjeve të mundshme, mund të jenë realisht më të mëdha nga pritet e rregullatorëve.

Kufizimi i rrezikut sistemik është objektivi i politikave makroprudenciale. Ato synojnë të trajtojnë rritjen e rrezikut sistemik në dy dimensionet e tij: (1) të zhvillimit përgjatë kohës, që lidhet me fazat e ciklit të ekonomisë; dhe (2) të shtrirjes ndërsektoriale, që lidhet me ekspozime të institucioneve financiare në produkte ose instrumente të njëjta/të ngjashme të mjeteve dhe të detyrimeve, si edhe shkallën e përqendrimit të tyre. Në 2-3 vitet e fundit, në BE e më gjerë, ka pasur përparim të dukshëm në identifikimin e disa instrumenteve, që synojnë të trajtojnë zgjerimin e shpejtë dhe përqendrimin në veprimtarinë huadhënëse, të sigurojnë që bankat kanë likuiditet të mjaftueshëm për të përballuar goditjet e ndryshme, e të shmangin sjelljet e rrezikshme nga ana e institucioneve financiare, duke rritur koston e tyre nëpërmjet rritjes së kërkesës për kapital për disa veprimtari të caktuara. Këto instrumente mund të kenë natyrë kundërciklike e të zbatohen në mënyrë më të diferencuar për institucionet

financiare me rëndësi sistemike. Më tej këto standarde kërkojnë ndërtimin e një kuadri institucional sa më të qartë për identifikimin e autoritetit/autoriteteve që do të kenë kompetenca të natyrës makroprudenciale, në përputhje me legjislacionin, strukturën dhe nivelin e zhvillimit të tregut.

Në Shqipëri, sektori bankar shmangu ndikimin e drejtpërdrejtë nga kriza financiare globale, por sidoqoftë e ndjeu ndikimin e saj nëpërmjet politikave të shtuara të kujdesit të grupeve bankare, ngadalësimit të zhvillimit ekonomik në vend, si edhe ndryshimit të sjelljes së konsumatorit të shërbimeve bankare. Ngadalësimi i zhvillimit ekonomik i kombinuar me

Në këto kushte, si dhe për shkak të zbritjes së normës bazë të interesit në nivele mjaft të ulëta, ka të ngjarë që diskutimet për politikën monetare në të ardhmen të konsiderojnë gjithnjë e më shumë pasojat që ato kanë për stabilitetin financiar.

rënie e besimit të bizneseve dhe familjeve për ecurinë e ekonomisë në të ardhmen, u shoqërua me dobësimin e kërkesës private për financim, që rezultoi në ngadalësimin e dukshëm të huadhënies nga bankat. Rënia e cilësisë së portofolit të huas bankare, pasoi ngadalësimin e të ardhurave dhe përkeqësimin e situatës së likuiditetit të huamarrësve, duke nxitur shtërngimin e kushteve të huadhënies nga bankat, veçanërisht për bizneset. Kështu, aftësia e sektorit bankar për të krijuar rezultat financiar pozitiv në mënyrë të qëndrueshme është dobësuar. Megjithatë, depozitat e publikut përfaqësojnë burimin kryesor e mbizotërues të financimit të tij, ndërkohë që madhësia e aktiveve likuide dhe treguesit e kapitalit janë në nivele të mira.

Banka e Shqipërisë (BSH), si autoritet mbikëqyrës, rregullativ e monetar në vend ka harmonizuar veprimet e saj në disa drejtime. Lidhur me mbikëqyrjen mikroprudenciale, BSH ka intensifikuar veprimet operacionale për identifikimin e qartë dhe sa më të plotë të problemeve me cilësinë e huas. Politikat mbikëqyrëse kanë vendosur kriteret minimale për llojin dhe madhësinë e aktiveve likuide dhe të kapitalit, në varësi të profilit të rrezikut të çdo institucioni bankar. Së bashku me industrinë bankare dhe autoritetet tjera publike që monitorojnë tregun financiar, janë identifikuar dhe propozuar ndryshimet e nevojshme ligjore për përmirësimin e ekzekutimit të kolateralit në fazën e rekupeimit të huas. Në bashkëpunim me autoritetet mbikëqyrëse të vendeve të origjinës, është siguruar një ndjekje më e mirë e ecurisë së situatës financiare të grupeve bankare zotëruese. Për sa i përket politikave makroprudenciale, BSH ka punuar për vlerësimin e rrezikut sistemik, përmes ndërtimit të metodologjive përkatëse, duke përfshirë edhe zhvillimin e vrojtimeve të ndryshme për njohjen e perceptimit të industrisë bankare, për vlerësimin e ngarkesës me borxh të bizneseve dhe të familjeve, si edhe për vlerësimin në shkallë më të gjerë të vlerës së pasurive të paluajtshme. Aftësia e sektorit bankar për të përballuar rreziqet ndaj zhvillimeve të pafavorshme në kuadrin makroekonomik, vlerësohet përmes kryerjes së rregullt të ushtrimit të provës së rezistencës, jo vetëm nga Banka e Shqipërisë, por prej 2 vjetësh, edhe përmes përfshirjes aktive në vlerësimin e rezultateve prej bankave më të mëdha. Gjatë këtij viti, BSH zbatoi edhe disa masa me afat të përkoh-

shëm e me natyrë kundërciklike, me qëllim nxitjen e huadhënies, si: uljen e kërkesave për kapital për shtesën vjetore të huas në një masë të caktuar deri në fund të vitit 2014, si edhe disa stimuj në drejtim të ristrukturimit të hershëm të huas. Në nivel ndërinstitucional, prej fillimit të vitit 2012, ka nisur funksionimi formal i Grupit Këshillimor të Stabilitetit Financiar, drejtuar nga ministri i Financave, ku Banka e Shqipërisë kryen edhe rolin e sekretariatit. Në këtë kuadër, janë diskutuar dhe mbështetur disa procedura, që forcojnë kapacitetet e autoriteteve pjesëmarrëse në trajtimin e rreziqeve sistemike. Lidhur me politikën monetare, në kushtet e trysnive të dobëta inflacioniste, BSH ka ndjekur një politikë monetare lehtësuese, duke zbritur normën bazë të interesit në nivelin më të ulët historik prej 3.5% dhe duke ofruar sasitë e nevojshme të likuiditetit në tregun ndërbankar. Në këto kushte, si dhe për shkak të zbritjes së normës bazë të interesit në nivele mjaft të ulëta, ka të ngjarë që diskutimet për politikën monetare në të ardhmen të konsiderojnë gjithnjë e më shumë pasojat që ato kanë për stabilitetin financiar.

Pavarësisht këtyre zhvillimeve, sektori bankar dhe sistemi financiar duhet të përballen me sfida të rëndësishme, ku në afat të shkurtër, më kryesorja është trajtimi i huave me probleme dhe ruajtja përgjatë gjithë këtij procesi i niveleve të përshtatshme të kapitalizimit dhe likuiditetit. Së

Në afat të mesëm, kuadri rregullativ mbikëqyrës dhe ai i politikave makroprudenciale duhet të reflektojë zhvillimet në standardet ndërkombëtare. Për këtë, theksi duhet vendosur në përsosjen e kuadrit institucional dhe në identifikimin e instrumenteve konkrete, që do të përdoren për kufizimin e rreziqeve financiare.



fundi, diskutimet më konkrete për shlyerjen e shpejtë të detyrimeve të prapambetura publike ndaj bizneseve, nëse materializohen, pritet të japin një kontribut të rëndësishëm në përmirësimin e klimës së biznesit në vend. Që ky efekt të jetë maksimal edhe në drejtim të shlyerjes së huave me probleme që këto biznese kanë ndaj sektorit bankar, është e nevojshme që shlyerja e detyrimeve t'i japë përparësi subjekteve që kanë borxh të papaguar ndaj një ose më shumë bankave dhe të shoqërohet me mekanizma që sigurojnë fillimisht pagesën e këtij borxhi, përkundër detyrimeve të tjera të bizneseve. Financimi i këtij procesi do të kërkojë burime financiare shtesë nga ana e qeverisë, duke sjellë rritje të deficitit dhe të borxhit publik. Financimi është i mundur si me burime të brendshme ashtu edhe me burime të huaja, por në rastin e dytë do të shmangej rritja e trysnisë mbi normat e interesit të borxhit të qeverisë, duke ruajtur njëtrajshmërinë me ecurinë e normës bazë të interesit, duke mos çenuar potencialin huadhënës të bankave ndaj sektorit privat. Në afat të mesëm, kuadri rregullativ mbikëqyrës dhe ai i politikave makroprudenciale duhet të pasqyrojë zhvillimet në standardet ndërkombëtare. Për këtë, theksi duhet vendosur në përsosjen e kuadrit institucional dhe në identifikimin e instrumenteve konkrete, që do të përdoren për kufizimin e rreziqeve financiare, veçanërisht për bankat me rëndësi sistemike, duke synuar mënyrën e përdorimit të tyre në mënyrë simetrike, në përputhje me ciklin e zhvillimit të ekonomisë dhe veprimtarisë bankare.

## BANKAT TAKOHEN ME KRYEMINISTRIN E RI – Një tryezë shumë e rëndësishme

Sektori bankar i paraqiti Kryeministrit të ri SH.T. Edi Rama disa propozime të rëndësishme dhe pret që qeveria e re të mund t'i konsiderojë dhe trajtojë ato me vëmendje, me qëllimin përfundimtar atë të rritjes së ritmeve të huadhënies dhe rigjallërimit të ekonomisë.

Në datën 25 korrik 2013, Kryeministri i zgjedhur, SH.T. Edi Rama (tashmë Kryeministër) u takua me drejtues të bankave dhe Bankës së Shqipërisë, në një tryezë të rrumbullakët, si një vazhdimësi e filozofisë së dialogut, midis Bankës së Shqipërisë, sistemit bankar dhe qeverisë, për të diskutuar mbi politikën ekonomike që i shërbejnë rritjes së shpejtë, të shëndetshme e të qëndrueshme të vendit, sikundër dhe për të shpallur çështjet kryesore, që shqetësojnë sot komunitetin bankar. Në këtë takim, bankat theksuan dhe një herë se mirëpresin dhe inkurajojnë dialogun e vazhdueshëm dhe proaktiv mes të gjithë palëve, për përmbushjen e objektivave të përbashkëta. Sikundër theksoi dhe z. Adrian Fullani, Guvernator i Bankës së Shqipërisë: "... sektori bankar është jo vetëm kon-

tribuuesi më i madh dhe më efektiv në rritjen ekonomike të vendit, por njëkohësisht është dhe kujdestari i kursimeve të familjeve shqiptare dhe përcaktuesi i destinacionit të fondeve në ekonomi".

Gjithsesi, në kuadër të zhvillimeve të sotme brenda mjedisit ekonomik, një nga çështjet që meriton vëmendje të veçantë është ekuilibri vital i stabilitetit financiar në vend, i cili duhet të vazhdojë të jetë një prioritet konstant dhe në harmoni të plotë me politikën nxitëse zhvillimore. Nga ana tjetër, nisur nga situata e ngadalësimit ekonomik dhe tkurria e huadhënies, si dhe pavarësisht nga fakti që sistemi bankar ka punuar mirë për të ruajtur shëndetin e tij dhe për t'u zgjeruar gjithnjë e më shumë, bankat sollën në vëmendjen e Kryeministrit një listë masash dhe rekomandimesh për

përmirësime të menjëhershme, me synim rritjen e vëllimit të huadhënies dhe rigjallërimit të ekonomisë kombëtare, si vijon:

1. ndërmarrja e reformave fiskale dhe konsolidimi i regjimit tatimor, si kushte për luftën kundër informalitetit dhe evazionit fiskal, me anë të tatimit të ndershëm të biznesit, mbledhjes së detyrimeve tatimore faktike dhe reduktimin e qarkullimit të parasë në ekonomi dhe zhvendosjen drejt kanaleve elektronike;
2. riformulimi i një kuadri ligjor tatimor të qartë, gjithëpërfshirës dhe të përputhshëm, me qëllim që të mos lihen hapësira për keqinterpretim dhe praktika abuzive nga administrata tatimore, veçanërisht në lidhje me elementë të ndjeshëm për sektorin bankar, si: provizio-





## QËNDRUESHMËRI FINANCIARE DHE RITJE EKONOMIKE: NJË BINOM?!

- net dhe fshirjen apo rivlerësimin e borxhit të keq nga pasqyrat financiare;
- ekzekutimi i kolateraleve nëpërmjet një procesi të ndershëm, të drejtë dhe të pavarur ligjor, ku "shteti ligjor" të njihet dhe respektohet si zgjidhje e shpejtë dhe efikase nga të gjitha palët;
  - liberalizimi i plotë i zyrove përmbartimore, me qëllim operimin në kushtet e konkurrencës së tregut të lirë; në këtë drejtim nevojiten ndryshime në lidhje me mënyrën e pagesës të këtyre shërbimeve drejt një tarife të përpjesshme, të pagueshme në raport me shumën e detyrimit të mbledhur nga zyrat përmbartimore (tarifë suksesi);
  - stimuli i bizneseve shqiptare, duke iu shlyer shoqërive që kanë shuma financiare për të marrë nga shteti, si në formën e rimbursimeve të TVSHsë, ashtu edhe të detyrime të papaguara dhe realizimi i investimeve infrastrukturore nën përgjegjësinë e qeverisë;
  - qasje më lehtë për bankat ndaj informacionit të besueshëm nëpërmjet platformave elektronike, si: regjistri elektronik i Zyrës së Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme (ZRPP) dhe Sigurimeve Shoqërore (të ardhura të deklaruara jo reale);
  - zhvillimi i një tregu të pasurive të paluajtshme, duke e bërë atë likuid dhe me çmime të rregullueshme, nëpërmjet dixhitalizimit, regjistrimit të shpejtë dhe zhvillimit të ankandeve private, në mënyrë që bankat të jenë të afta të disponojnë mjetet e tyre, pasi t'i kenë mbledhur ato;
  - formalizimi i të drejtave të pronave, nëpërmjet një regjistrimi të plotë të pronave, pasi titujt e qartë dhe regjistrimi i pronësive do të mbështesin aftësinë e bankave për ofrimin e huave të sigurta;
  - ndryshimi i ri i ligjit "Për barrat siguruuese", i cili me ndryshimin e fundit në mënyrë të gabuar e ka bërë tashmë të pamundur vendosjen si kolateral të letrave me vlerë të zotëruara nga individët dhe pasuritë prona të tjera të paluajtshme, si: "të arkëtueshmet", e "faturat", duke marrë parasysh që ky tip kolateral konsiderohej si më i përdorshmi në praktikën bankare. Së fundi, bankat i shprehën Kryeministrit mbështetjen e tyre për zbatimin e masave të sipër sugjeruara që do të kontribuojnë në gjallërimin e veprimtarisë së sektorit bankar në Shqipëri, si një pjesë thelbësore të ekonomisë në vend.



nga Prof. Dr. Sulo HADËRI  
Dekan, Fakulteti i Ekonomisë  
Universiteti i Tiranës

Jehona e situatës së rëndë të shtetit-ishull në veri të Europës, Islandës, gjatë periudhës së krizës financiare botërore nuk është shuar ende. Problemet me bankat dhe paqëndrueshmëria financiare që precipituan në situatë të vështirë ekonomike në të cilat kërkohet dorëheqja e drejtuesve të bankës qendrore të vendit, zgjedhje të reja për parlamentin dhe ndryshime në qeveri. Më 26 janar 2009 Kryeministri i Islandës dha dorëheqjen dhe më 1 shkurt Kryeministria e sapoemëruar shpalli planin për të shpëtuar Islandën nga rrënimin financiar, duke pasur si përparësi në planin e saj zëvendësimin e Këshillit të Bankës Qendrore, i cili nuk arriti të parandalonte shembjen e sistemit bankar dhe bashkimin me BE-në.

Ky shembull i një ekonomie të vogël e të zhvilluar, është tepër domethënës për të kuptuar përmasat e pasojave të paqëndrueshmërisë financiare. Aktualisht, qëndrueshmëria financiare është kthyer në një çështje të rëndësishme, veçanërisht pas krizës më të fundit financiare botërore të vi-

Qëndrueshmëria financiare në vetvete është një "e mirë publike", por nuk duhet ngatërruar me ngurtësinë. Nga ana tjetër, qëndrueshmëria nënkupton që duhet të shmangen luhatjet dhe marrja përsipër e rreziqeve të tepërta që çojnë në paqëndrueshmëri.

teve 2007-2010, si rrjedhojë e pasojave të rënda që mund të ketë ajo në ekonomi dhe përhapjen e gjerë të tyre. Një ndër mësimet e rëndësishme të krizës që po lëmë pas, është se rritja e pafre e sektorit financiar ka rrjedhja që rrezikojnë si botën e zhvilluar, ashtu edhe atë në zhvillim, duke shtruar edhe nevojën dhe debatet që politikëbërësit të rimendojnë disa nga parimet e drejtimit ekonomik.

Në fakt, debati mbi qëndrueshmërinë financiare dhe ndikimit apo lidhjes me rritjen ekonomike është një debat më i hershëm. Zhvillimi ekonomik dhe mënyra se si financiohet ky zhvillim është trajtuar sipas dy shkollave të mendimit: (1) nga njëra anë qëndrojnë mbështetësit e pikëpamjes se ndjekja e politikave të qëndrueshmërisë monetare dhe financiare nuk është në të njëjtën linjë me zhvillimin; (2) nga ana tjetër janë përkrahësit e pikëpamjes se ndjekja e politikës së qëndrueshmërisë financiare është mënyra më e mirë për të arritur një zhvillim ekonomik të balancuar. Debati midis këtyre dy shkollave të mendimit është zhvilluar prej

Politika monetare është e dobishme për të riparuar dëmet e paqëndrueshmërisë financiare, sepse nëpërmjet saj mund të parandalohen pasojat negative makroekonomike të paqëndrueshmërisë financiare, nëpërmjet normave të interesit (uljen e tyre) apo nëpërmjet kanalit të kreditit.

kohësh dhe ato kanë mbizotëruar njëra-tjetrën, në varësi të situatave të përjetuara nga ekonomi të ndryshme. Mjafton të kujtojmë që Federal Reserve System u krijua si reagim ndaj situatës së panikut bankar të vitit 1907, për të nxitur qëndrueshmërinë financiare.

Qytetari i zakonshëm me njohuri të përgjithshme ekonomike do të shprehej se qëndrueshmëria financiare mbështet dhe nxit rritjen ekonomike, por në realitet nuk është kështu patjetër. Në literaturën ekonomike kjo marrëdhënie nuk gjen shumë trajtim, ndërkohë që përcaktimi se çfarë është në të vërtetë qëndrueshmëria financiare mbetet i debatueshëm, kanalet e transmetimit nuk janë të përcaktuara qartësisht dhe ndjehet mungesa fakteve bindëse empirike, që lidhin qëndrueshmërinë financiare me rritjen. Pra, nëse niveli i zhvillimit financiar shoqërohet me të vërtetë me rritje ekonomike, ende nuk e dimë nëse qëndrueshmëria financiare po ashtu shoqërohet nga rritja. Nga ana tjetër, ka përkrahës të idesë se paqëndrueshmëria financiare zakonisht prirë të vonojë rritjen ose ta ndalojë atë, sepse një sistem financiar i paqëndrueshëm, i cili ekspozohet ndaj falimentimeve ose që nuk e kryen me efektshmëri funksionin e ndërmjetimit, do të zhvillohet ngadalë dhe për rrjedhojë do të ngadalësojë rritjen ekonomike. Megjithatë, zhvillimi financiar në thellësi shoqërohet me rritje ekonomike. Pra, ajo çka mund të thuhet është që paqëndrueshmëria financiare e vonon rritjen ekonomike



dhe për rrjedhojë pranohet që qëndrueshmëria është më e mirë për të krijuar një mjedis i cili nxit rritjen ekonomike.

Qëndrueshmëria financiare në vetvete është një "e mirë publike", por nuk duhet ngatërruar me ngurtësinë. Ekonomia ka nevojë për çmime fleksibël, struktura fleksibël, falimentim të institucioneve financiare nëse nuk përmbushin si duhet rolin e tyre apo nuk drejtohen mirë dhe kanë probleme në qeverisje. Por nga ana tjetër, qëndrueshmëria nënkupton që duhet të shmangen luhatjet dhe marrja përsipër e rreziqeve të tepërta që çojnë në paqëndrueshmëri. Pikërisht këto pikëpamje përcaktojnë rolin që duhet të luajnë bankat qendrore, në mbështetje të qëndrueshmërisë në sektorin financiar, por që duhet të jetë një mbështetje "e matur" për të synuar balancim të rreziqeve. Kjo është arsyeja që bankat qendrore gjithnjë e më tepër filluan të shtojnë theksin mbi qëndrueshmërinë financiare dhe po e shndërrojnë atë në një objektiv të politikës monetare. Madje ka marrë shtysë edhe prirja për të përfshirë objektivin e qëndrueshmërisë financiare në politikën monetare dhe se si duhet të reagojnë ato ndaj paqëndrueshmërisë financiare.

Padyshim që objektivat për qëndrueshmëri çmimesh dhe nxitje të punësimit mbeten të vlefshme për të pakësuar mundësitë e paqëndrueshmërisë financiare. Por, në këtë fushë të mendimit ekonomik e financiar, ashtu si dhe në shumë fusha të tjera, nuk ka receta të gatshme dhe

debati ende në zhvillim është nëse duhet që bankat qendrore të veprojnë paraprakisht ndaj flluskave të çmimeve të aktiveve, apo thjesht të riparojnë dëmet pasi ato plasën; nëse politika monetare zbutëse është tepër e zbutur; nëse janë apo jo të vlefshme mjetet e mbështetjes me likuiditet të tregut për të kthyer në ekuilibër kërkesën e përgjithshme, e kështu me radhë. Ajo që mund të thuhet është se në tërësi politika monetare është e dobishme për të riparuar dëmet e paqëndrueshmërisë financiare, sepse nëpërmjet saj mund të parandalohen pasojat negative makroekonomike të paqëndrueshmërisë financiare, nëpërmjet normave të interesit (uljen e tyre) apo nëpërmjet kanalit të kreditit. Politika monetare mund të ndihmojë në restaurimin e qëndrueshmërisë financiare duke kontribuar në rrjedhjen e informacionit nëpërmjet uljes së pasigurisë në treg, duke zbutur politikën monetare. Por që të arrihet ky ndikim politika monetare është e nevojshme të marrë vendime në kohë, bindëse dhe fleksibile. Në kontekstin e sigurimit të rritjes së qëndrueshme, një tjetër detyrë e rëndësishme mbetet rritja e edukimit financiar dhe mbrojtja e investuesve.

Duket se ka një prirje të qartë se bankat qendrore do të forcojnë theksin mbi objektivin e qëndrueshmërisë financiare dhe mbikëqyrjes e rregullimit në nivel makroekonomik. Në këtë aspekt do të duhet të forcohet bashkërendimi i bankave qendrore me autoritetet të tjera palë të procesit brenda vendit dhe përtej kufijve.

## INTERESAT, BUXHETI I SHTETIT DHE EKONOMIA - “I miri, i keqi dhe i shëmtuari”

Shqipëria po përballet, jo për herë të parë, me një situatë ku një pjesë e huamarrësve falimentojnë. Mënyra e menaxhimit të procesit të falimentimit do të përcaktojë gatishmërinë e bankave për të dhënë hua, rrjedhimisht edhe fuqinë e Bankës së Shqipërisë për të ndikuar në këtë treg.

*nga Z. Gjergj EREBARA*

Në janar 2012, interesat bazë në Shqipëri ishin 4.5%, sot janë 3.5%. Interesat mesatare të huave në lek, për periudhën janar-korrik 2012, ishin 11.4%, ndërsa për të njëjtën periudhë të këtij viti, ishin 10.9%. Nëse interesi bazë është ulur me 1%, një ulje agresive kjo, me shpresën e uljes së interesave të huave, e rrjedhimisht rritjen e huadhënies, efekti është vetëm marzhinal; për vëllimin, as që mund të flitet. Ndërsa Banka e Shqipërisë ndjek politikën e saj agresive të uljes së interesave, vëllimi i huas së re në lek jo vetëm që nuk rritet, por përkundrazi, ulet. Gjatë shtatëmuajorit të këtij viti, bankat dhanë hua të re 15% më pak sesa një vit më parë, kur interesat ishin më të larta.

Por, ka një fushë ku interesat kanë pësuar ulje: bonot e thesarit një-vjeçare. Që nga fillimi i vitit 2012, ato siguronin një yield mbi 7%. Në ankandin e fundit, u kuotuan në shifrën e pabesueshme të 4.3%. Kjo rënie drastike e interesave të borxhit publik vjen në një kohë kur vëllimi i huamarrjes së qeverisë, është rritur. Thjesht duket se ka shumë më tepër kërkesë të borxhi publik, pavarësisht faktit se sa është shtuar deficitit buxhetor e huamarrja publike. Në pamje të parë, duket se politika monetare ka një ndikim modest ose minimal te huadhënia në lek, ndërkohë ka një efekt të dukshëm te borxhi publik. Por kjo është një panoramë iluzive dhe politika monetare nuk është

mjeti i duhur për të interpretuar atë. Mjeti i duhur është në fakt shkalla e rrezikut.

Shqipëria po përballet, jo për herë të parë, me një situatë ku një pjesë e huamarrësve falimentojnë. Mënyra e menaxhimit të procesit të falimentimit do të përcaktojë gatishmërinë e bankave për të dhënë hua, rrjedhimisht edhe fuqinë e Bankës së Shqipërisë për të ndikuar në këtë treg. Ky rrezik, i shfaqur në rritjen e huave me probleme e në vështirësitë në ekzekutimin e kolateraleve, ka bërë që interesat e huave të mbeten të larta, vëllimi i huave të tkurret dhe interesat e borxhit publik, si streha e fundit përballë rreziqeve, të ulen. Shqipëria u përball me një situatë të ngjashme në vitin 1998, kur huat me probleme nuk u mblodhën, për mungesë vullneti politik. Në prill 1998, bankave iu ndalua me akt rregullativ huadhënia e, rrjedhimisht, për to in-

A jemi në të njëjtën situatë si më 1998-ën (me ndryshimin e vogël që kësaj here nuk ka një akt rregullativ për t'i shpallur bankat të paafta për të dhënë hua, por bankat “shpallin” ekonominë shqiptare “të paaftë” për të marrë hua)?

vestimi në bono thesari u bë burimi i vetëm i të ardhurave. U deshën shumë vite, si dhe një proces pastrimi bilancesh të bankave shtetërore, që u kushtoi taksapaguesve 200 milionë dollarë, para se tregu i huadhënies të riniste punën.

Interesi bazë është vetëm një pjesë e kostos që huamarrësit paguajnë kur marrin hua; pjesa më e madhe e kostos, primi i rrezikut, nuk ndikohet nga kjo. A jemi në të njëjtën situatë si më 1998-ën (me ndryshimin e vogël që kësaj here nuk ka një akt rregullativ për t'i shpallur bankat të paafta për të dhënë hua, por bankat “shpallin” ekonominë shqiptare “të paaftë” për të marrë hua)? Një ekonomi pa huadhënie është një ekonomi pa investime (ose një ekonomi me akumulim primitiv të kapitalit). Pa investime nuk mund të ketë rritje ekonomike dhe zgjidhja e problemit është e tripërmasore: (1) duhet fuqizuar shteti ligjor, nëpërmjet lehtësimit të ekzekutimit të kolateralit, e duke nxitur bankat të japin hua të reja; (2) duhet të ulet borxhi publik, që të çlirohen fonde për t'u përdorur në kreditimin e ekonomisë private dhe më delikatja; (3) duhen ulur rreziqet në ekonomi, që automatikisht ul rrezikun/koston e huadhënies bankare.

Në total, Shqipërinë e pret një periudhë disi e gjatë stanjacioni, apo rritje anemike, në rast se nuk i përgjigjet dhe trajton energjikisht (ndoshta intensivisht) këto tre sfida madhore.



**Transferta  
të shpejta**

Kosovë

Maqedoni

Shqipëri

**ProCredit Bank ju lidh me  
partnerët tuaj të biznesit  
me transfertat ProPay.**

## Një filozofi bankingu me gjashtë shtylla



**Z. Gazmend KADRIU**  
Drejtor Ekzekutiv  
Union Bank

**BANKIERI:** CILA ËSHTË FILOZOFIA E BANKËS QË NGA KRIJIMI I SAJ RETH 8 VJET MË PARË DHE CILI ËSHTË ASPEKTI UNIK I SAJ NË TREG?

Sikurse edhe çdo bankë tregtare, arsyeja parësore e krijimit/ekzistencës së Union Bank është prodhimi i një fitimi të kërkuar nga aksionerët. Këtu nuk ka dallime ndërmjet bankave. Filozofia e bankës, mënyra e zgjedhur për arritjen e synimit, mund të dallojë. Në rastin e Union Bank, kjo filozofi është e shprehur nëpërmjet gjashtë shtyllave në dokumentin tonë strategjik. Ato mund të prezantohen kështu:

(1) Punonjësit + (2) Komunikimi: Ne jemi të nderuar nga secili person që zgjedh Union Bank, si vend ku do të japë kontributin e vet profesional dhe do të synojë rritjen e vet si individ. Respektin për punonjësit tanë e shprehim edhe me një kulturë shumë të hapur komunikimi, në të gjitha nivelet. Kjo gjen reflektim edhe në shpalljet e targeteve, bonuseve, rishikimit të pagave, vlerësimet vjetore, karrierën e brendshme... një transparencë maksimale në secilin aspekt të rëndësishëm që prek punonjësit tanë. Stafi ynë i mrekullueshëm e meriton këtë.

(3) Shërbimi i Klientit + (4) Shitja: Synimi i shpallur i bankës tonë është i thjeshtë: "Banka numër 1 në Shqipëri për shërbim klienti". Në qoftë se cilado bankë në Shqipëri rezulton me shërbim më të mirë se ne, atëherë konsiderojmë që ende nuk e kemi realizuar këtë objektiv madhor të bankës. Rritjen e shitjes e synojmë nëpërmjet shërbimit të klientit, si element dallues në një treg, ku pak a shumë produktet dhe ofertat janë të ngjashme/krahasueshme.

(5) Fitimi + (6) Rreziku: Faktorin "fitim", këtë qëllim fundor, nuk e shohim të ndarë nga çështja e rrezikut. Fitimi është shpesh një çështje horizonti të shkurtër, ndërsa Rreziku është më pak i dukshëm në çast, por jashtëzakonisht i dukshëm më vonë. Nuk mund të na ndodhë që të sakrifikojmë rrezikun në afat të gjatë për hir të fitimit në një periudhë të caktuar.

**BANKIERI:** CILA ËSHTË ARRITJA KRYESORE E BANKËS DERI ME TANI?  
Kryesorja është që arritëm të krijojmë një bankë që kënaq kër-

Kryesorja është që kemi arritur të krijojmë një bankë që kënaq kërkesën tonë të brendshme, duke nisur nga aksionerët e poshtë, për një bankë serioze, të qëndrueshme dhe në rritje konstante.

kesën tonë të brendshme, duke nisur nga aksionerët e poshtë, për një bankë serioze, të qëndrueshme dhe në rritje konstante. Arritjet e detajuara i matim edhe ndaj shtyllave strategjike të vendosura, ato gjashtë shtylla të përmendura më lart:

- Punonjësit/Komunikimin e matim, në instancë të fundit, me qëndrimin e tyre në bankë. Jemi shumë krenarë për stabilitetin e jashtëzakonshëm të stafit tonë. Sidomos drejtuesit e niveleve të ndryshme vazhdojnë gati pa përjashtim të punojnë në bankë.
- Shitjen/Shërbimin e Klientit e matim jo me analiza tona të brendshme, por duke iu nënshtruar gjykimit të atyre që janë në pozitë t'i krahasojnë bankat: klientët individualë dhe shoqëtitë e specializuara që ndërmarrin analiza të ndryshme tregu. Tek vlerësimet e tyre gjejmë kënaqësinë tonë.
- Rrezikun/Fitimin e matim me treguesit e ndryshëm të rrezikut disponibël në treg. Jemi sidomos krenarë që me këmbëngulje arrijmë të jemi bankë shumë e pastër nga ana etike, e thënë me shqip: nuk marrim ryshfet për të dhënë kredi, nuk japim ryshfet për të kapur punë.

**BANKIERI:** PSE KLIENTET DUHET TË ZGJEDHIN BANKËN UNION?

Nuk dua të jem unë ai që do listojë se pse një klient duhet të zgjedhë bankën tonë. Të interesuarit le të pyesin klientët tanë ekzistues se a vlen të jesh klient i Union Bank. Pastaj, kur të binden të vinë në bankë... do të gjykojnë vetë për këtë.

**BANKIERI:** CILI ËSHTË OBJEKTIVI KRYESOR I BANKËS NË AKTIVITETIN E SAJ NË VIJIM?

Objektivi ynë i parë është vazhdimi i rrugës që kemi nisur, i një banke që do të kënaqë kërkesat tona të larta të brendshme për një bankë serioze dhe të qëndrueshme, kërkesat e punonjësve tanë për një vend pune të këndshëm dhe dinjitoz, kërkesat e klientëve tanë për shërbim superior. Objektivi fundor është arritja e kërkesave të aksionerëve tanë për fitimin e kërkuar, në radhë të parë me rritjen organike të bankës, por pa përjashtuar edhe blerjen e institucioneve të tjera.

## PËRBALLJA ME STANJACIONIN EKONOMIK



**nga Z. Kaan PEKIN**  
Drejtor i Grupit të Thesarit &  
Institucioneve Financiare  
Banka Kombëtare Tregtare

Qeveria e re shqiptare ka një detyrë të vështirë lidhur me stimulimin e ekonomisë shqiptare. Shqipëria ka nevojë për një model të ri ekonomik, për të nxitur rritjen ekonomike. Sipas programit ekonomik të qeverisë së re të qendrës së majtë, objektivat e ardhshme janë të mirë përcaktuar; pra është imperativ nxitja e prodhimit industrial vendas dhe rritja e eksporteve, duke u përqëndruar në zhvillimin e sektorëve kyç të ekonomisë, ku Shqipëria mund të krijojë më shumë përparësi krahasuese ndaj fqinjëve të saj. Objektivi përfundimtar është sigurimi i 300.000 vende të reja pune në 4 vitet e ardhshme. Por ka disa kufizime thelbësore mbi mënyrën se si do të arrihen këto dhe rruga e realizimit të kësaj mirëqenieje është i panjohur.

Së pari, do përpiqem të trajtoj disa prej këtyre kufizimeve. Arka e shtetit ka nevojë urgjente për fonde, për të paguar detyrimet ndaj projekteve në proces dhe TVSH-në e parimbursuar ndaj sektorit privat. Pa u shlyer këto detyrime, është thuajse e pamundur të thuhet rrethi vicioz që po dëmton ekonominë kombëtare. Sektori privat i është rikthyer të kaluarës, duke u përpjekur të mbijetojë, nëpërmjet përdorimit të *barter-it*. Shteti është i

Ekonomia shqiptare ka nevojë për një stimul (financim), që mungon tashmë në ekonominë vendase. Kjo mund të bëhet nëpërmjet huazimit të fondeve të reja nga jashtë, ose duke përdorur një burim financimi, që nuk është në sistemin e brendshëm financiar.

kufizuar në drejtim të grumbullimit të fondeve të reja dhe të ardhurat buxhetore janë në rënie. Për periudhën janar -korrik 2013 të ardhurat buxhetore ranë me 2.6% në 185.4 mld Lekë, e kjo krejtësisht për shkak të të ardhurave tatimore, që ranë me 3.2%. Në këtë kuadër, të ardhurat e kombinuara nga taksat indirekte ranë me 5.9 %, kurse të ardhurat nga TVSH-ja u ulën me 6%, ku TVSH-ja e mbledhur nga doganat, ra me 7.2%. Për më tepër, të ardhurat doganore dhe akcizat ranë respektivisht me 10.2% dhe 4.9%. Ulja e të ardhurave nga taksat indirekte sinjalizojnë një stanjacion të vazhdueshëm të konsumit të brendshëm. Djalli përsëri fshihet në detaje.

Logjikshëm, FMN-ja sugjeron fort recetën e saj klasike. Ajo kërkon politika të shtrënguara fiskale, si spiranca kryesore për ekonominë. Paketat alternative të FMN-së përfshijë rritjen e taksave ose tatimet indirekte, si: TVSH-ja, tatimin mbi fitimin dhe mbi të ardhurat personale, ose kombinimin e tyre me një reformë të fortë të administrimit fiskal. Por këto paketa nuk marrin parasysh rrezikun serioz të recesionit në ekonominë shqiptare dhe mbështeten në supozimin teorik se të ardhurat nga taksat do të rriten, nëse shteti rrit normën e taksave. Personalisht, besoj se sektori privat nuk ka fuqi të paguajë më shumë taksë, qoftë në formën e tatim-fitimit, qoftë të tatimit mbi të ardhurat personale. Rritja e taksave do të rezultojë në rritjen e evazionit fiskal në sektorin privat, pavarësisht nga reforma në administrimin fiskal. Nga ana tjetër,

rritja e TVSH-së zbatohet më lehtë, por ajo kërcënon mirëqenien sociale. Për më tepër, një rritje të vogël në 3-4% mund të përkeqësojë më shumë konsumin e brendshëm dhe të ulë të ardhurat nga TVSH-ja. FMN-ja nuk merr parasysh se formula e saj magjike e raportit të borxhit ndaj PBB-se prej 60 %, është një thikë me dy presa. Përpjekja për të rritur të ardhurat përmes rritjes të taksave për të ulur borxhin, mund të pengojë rritjen e PBB-së dhe raporti i borxhit ndaj PBB-së mund të përkeqësohet më tej. Në kohët e recesioneve ekonomike, personalisht favorizoj politikat që stimulojnë rritjen sesa “politikat fiskale ankoruese”. Kjo mund të realizohet vetëm me një vullnet të fortë politik nga qeveria për të paguar më pak për shpenzimet korrente, por më shumë

Personalisht besoj se sektori privat nuk ka fuqi të paguajë më shumë taksë, qoftë në formën e tatim-fitimit, qoftë të tatimit mbi të ardhurat personale. Rritja e taksave do të rezultojë në rritjen e evazionit fiskal në sektorin privat, pavarësisht nga reforma në administrimin fiskal.

për shpenzimet kapitale.

Qeveria e re ende po shqyrton alternativa dhe rezultate të tjera. Një alternativë është që të një pjesë e mirë e detyrimeve ndaj bizneseve të shlyhen përmes ofrimit të letrave me vlerë të borxhit të brendshëm (bono thesari dhe obligacione). Rrjedhimisht, sektori privat do t'i sjellë për skontim këto instrumente borxhi pranë bankave. Bankat me një pjesë të këtyre letrave me vlerë, do të fshijnë disa prej huave me probleme nga bilancet e tyre. Por bankat nuk kanë likuiditete të tepërta për të skontuar këto letra me vlerë. Fondet e tepërta në lekë janë investuar tashmë në borxhin e qeverisë; kjo shpjegon pse yield-i mesatar i i bonove të thesarit 12 mujore zbriti në 3,847 %. Rrjedhimisht, vetëm një sasi e vogël e këtyre letrave me vlerë mund të skontohen. Për më tepër, nëse të gjithë vijnë në banka për të skontuar këto letra me vlerë që morën nga qeveria, bankat pashmangshmërisht do të rrisin normat e skontimit, për të blerë këto letra me vlerë dhe yield-et e borxhit në tregun parësor e dytësor, do të rriten. Bankat ndoshta nuk do të marrin pjesë në tregun parësor të bonove të thesarit dhe obligacioneve, por do t'i blejnë ato nga klientët me yield-e më të larta. Mangësia më e madhe e këtij opsioni është se ai nuk mund t'i japë frymëmarrje të re ekonomisë vendase, pasi paratë që mund të ofrojnë bankat për sektorin privat nëpërmjet skontimit të këtyre letrave me vlerë, janë ato që gjenden tashmë në sistem. Kjo mënyrë e shlyerjes së borxhit ekzistues nuk jep efekt shumëfishues në zgjerimin e ekonomisë shqiptare.

Në fakt, nëse përcaktohet qartë dilema, mund të merret përgjigja që fshihet në të. Ekonomia shqiptare ka nevojë për një stimul (financim), që mungon tashmë në ekonominë vendase. Kjo mund të bëhet nëpërmjet huazimit të fondeve të reja nga jashtë, ose duke përdorur një burim financimi, që nuk është në sistemin e brendshëm financiar. Klientët shqiptarë kanë pranë bankave shqiptare depozita strukturore në valutë të huaj. Ato janë strukturore, sepse këta klientë kanë kursime në euro; kursimet e tyre në lekë ata nuk i konvertojnë në euro. Këto kursime janë depozituar në shumicën e bankave shqiptare me hapjen me një maturim mesatar të ponderuar 1 vit ose më shumë. Një pjesë e konsiderueshme e këtyre depozitave në euro nuk mund të konvertohen në hua në euro për klientët vendas, por është investuar

jashtë vendit në instrumente me gradë të lartë besueshmërie, por me norma interesi tmerrësisht të ulëta. Disa banka nuk kanë mundësi të blejnë më shumë borxh të jashtëm të qeverisë shqiptare, për shkak të kufizimeve rregullatore, që e kufizojnë ekspozimin e bankave shqiptare ndaj borxhit të jashtëm të Shqipërisë në 20% të kapitalit të tyre rregullator. Nëse ky kufizim hiqet, bankat mund të investojnë më shumë në borxhin e huaj afatshkurtër e afatmesëm (1-3 vjet) të qeverisë shqiptare, duke i rikthyer investimet e tyre nga jashtë vendit. Kjo frymëmarrje e re mund të ofrojë stimulin për të cilin ekonomia shqiptare ka nevojë në afatin e shkurtër.


Në afat të gjatë, sugjerimi i mësipërm mund të ndikojë negativisht

Një alternativë është që një pjesë e mirë e detyrimeve ndaj bizneseve të shlyhen përmes ofrimit të letrave me vlerë të borxhit të brendshëm (bono thesari dhe obligacione). Rrjedhimisht, sektori privat do t'i sjellë për skontim këto instrumente borxhi pranë bankave.

në sistemin bankar shqiptar. Kjo mund të jetë një mënyrë e lehtë për të bërë biznes dhe mund të bëjë që bankat të shtyjnë përshtatjet e nevojshme në modelin e tyre të biznesit. Duhet të theksoj se, sot ky është një problem i zakonshëm në gjithë Europën. Të dhënat sugjerojnë se një pjesë të madhe e shumës prej 1miliard euro, që BQE pompoi në sistemin bankar nëpërmjet LTRO-së, u investua në borxhet sovraane. Z. Jens Weidmann, President i Bundesbank-ut, theksoi se së fundi nuk ka asnjë kufizim në ekspozimin e bankës ndaj një borxhi të caktuar sovran, ndërsa rreziku që ato ndërmarrin nga palët e treta kufizohet në 1/4 e kapitalit. Gjithashtu, borxhi sovran vendos për bankat pak ose aspak kërkesa për kapital. Kjo e ka bërë tërheqëse për bankat të investojnë në obligacione qeveritare dhe "tërheqja" drejt blerjes së borxhit sovran kombëtar u rrit gjatë krizës. Z. Weidmann bën thirrje që huadhënësit të kufizohen në blerjen e obligacioneve qeveritare dhe të heqin mënjane më shumë kapital, për të mbuluar rrezikun e tyre.

Por propozimi i Z. Weidmann do të sjellë ndryshime të mëdha në rregullimet bankare europiane dhe do duhen vite për të rënë dakord për to, e ai mund të ndikojë mbi politikëbërësit në BQE, ndërkohë që ata mund të konsiderojnë një tjetër LTRO (cit.FT).

Morali këtu është se Shqipëria duket sikur ka gjetur tashmë zgjidhjen e njërit prej problemeve në sistemin bankar evropian, por me koston e humbjes së armës së saj më të fuqishme, për të luftuar kundër stanjacionit të ekonomisë së saj.



# RRITJE E SHPEJTË



KREDI PËR BIZNESIN E MESËM  
NGA RAIFFEISEN BANK

- Interes 0% për shumën e papërdorur
- E shpejtë dhe e lehtë për t'u marrë





## BANKA DEPOZITARE – PARTNER PËR NJË MENAXHIM GJITHËPËRFSHIRËS TË FONDEVE TË PENSIONEVE DHE ATYRE TË INVESTIMEVE



**nga Zj. Elma LLOJA**  
Drejtoresh e Thearit,  
Banka e Parë e Investimeve  
Fibank Albania

Në dhjetor 2009, Kuvendi i Shqipërisë miratoi dy ligje të rëndësishme: “Për fondet e pensionit vullnetar” dhe “Për sipërmarrjet e investimeve kolektive (SIK)”, të domosdoshëm për ekonominë shqiptare, si përgjigje ndaj zhvillimeve aktuale në vend, e në përputhje me standartet bashkëkohore, duke synuar krijimin e një mjedisi të përshtatshëm për nxitjen dhe zhvillimin e tregjeve të kapitalit.

Ligji i parë synonte përmirësimin e sistemit ekzistues të pensioneve vullnetare në Shqipëri, duke nxitur qytetarët drejt kursimeve vullnetare për shtimin e pensioneve të tyre. Është fakt i mirënjohur që në Shqipëri, sistemi i pensioneve përbëhet vetëm nga kolona e parë dhe e tretë, pasi kolona e dytë mungon. Kolona e dytë dhe e tretë presupozojnë një kontribut shtesë që do të garantojë një jetesë më të kënaqshme në moshën e tretë. Ky ligj, si pjesë e reformës në kolonën e tretë të pensioneve nga ana e Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare, AMF, ndryshoi skemën e mëparshme të funksionimit të kolonës së tretë dhe rregulloi krijimin, veprimtarinë dhe

Tregu bankar shqiptar është tashmë i gatshëm dhe ka eksperiencën të ofrojë te klientët mundësi të reja për menaxhimin më me efektivitet të aktiveve të tyre, kurse klientët janë të gatshëm të përzgjedhin midis produkteve të reja dhe cilësore që iu propozohen nga bankat.

mbikëqyrjen e fondeve të pensionit vullnetar, me kontribute të përcaktuara. Në qendër të skemës u vendos shoqëria administruese, detyra e së cilës do të ishte administrimi dhe investimi i fondeve të pensioneve, në mënyrë të tillë që, të sigurojë një të ardhur sa më të mirë në favor të anëtarëve të fondit. Ky ligj, i bazuar në direktivat/rregulloret përkatëse të BE, si dhe udhëzimet e OECD-IOPS realizon ndarjen e konceptit të administrimit të fondit nga vete fondi i pensionit, që në vetvete konceptohet si grup aktivësh. Për herë të parë në ligjin “Për fondet e pensionit vullnetar” del koncepti i bankës depozitare, si një hallkë shumë e rëndësishme e procesit, përgjegjësia kryesore e të cilës është ruajtja e aktiveve të fondit

Për herë të parë në ligjin “Për fondet e pensionit vullnetar” del koncepti i bankës depozitare, si një hallkë shumë e rëndësishme e procesit, përgjegjësia kryesore e të cilës është ruajtja e aktiveve të fondit dhe kontrolli mbi administrimin e tyre, në përputhje me ligjin.

dhe kontrolli mbi administrimin e tyre, në përputhje me ligjin.

Fibank është njëra nga tri bankat e licencuara për të kryer funksionin e depozitarit të fondeve të pensioneve, funksion të cilin e kryen me sukses që nga viti 2010. Sipas të dhënave të AMF-së për fundin e tremujorit të parë të vitit 2013, në Shqipëri janë licencuar dhe operojnë 3 shoqëri administruese të fondeve private të pensioneve, me një numër total anëtarësh 7,289 dhe total asetesh mbi 300 milionë lekë. Sigurisht që reforma e pensionit në Shqipëri është një hap i duhur, me përfitime që vijnë për brezat në vazhdim dhe rritja e fondeve të pensioneve, si investuesit më të mëdhenj institucionalë do të rrisë kërkesën për klasa të reja aktivësh në treg, si dhe do të zhvillojë tregun e kapitaleve. Qeveria dhe rregullatorët duhet të jenë të përgatitur për këto kërkesa dhe duhet të krijojnë kushtet, ku këto fonde të mund të investojnë në tregun shqiptar.

Nga ana tjetër, ligji “Për sipërmarrjet e Investimeve kolektive (SIK)”, paraqet një tjetër hap serioz në drejtim të përcaktimit të rregullave për investimin masiv të kursimeve në ekonomi e që trajtohet nëpërmjet skemave të investimit kolektiv në portofole titujsh. Në këtë ligj, trajtohen skemat e investimeve kolektive, si një mënyrë e investimit të parave të një grupi investuesish, së bashku me qëllimin e përfitimit nga përparësia e të qenit pjesë e një grupi. Këto përparësi përfshijnë: mundësi investimi më të përshtatshme për individët,

Banka Depozitare është një pjesë e rëndësishme e zinxhirit të SIK-ve, pasi është pikërisht ajo që garanton se llogaritja e vlerës neto të aksioneve ose të kuotave në fond është shpallur në përputhje me ligjin, rregulloret përkatëse të AMF-së, prospektin dhe rregullat e fondit.



pasi ofron një mundësi për të investuar në një shportë të larmishme letrash me vlerë, e menaxhuar profesionalisht e me një kosto relativisht të ulët; ndarjen e koston mes anëtarëve, dh diversifikimi optimal midis një numri të madh alternativash investimi, që teorikisht dhe praktikisht, ul rrezikun e investimit.

Ky ligj i jep një rol thelbësor shoqërisë administruese të SIK-ve, duke treguar një kujdes të veçantë lidhur me politikat e investimit; investimet e lejuara për SIK-të si dhe kufizimet e investimit.

**Koncepti i Depozitarit - Një element i ri dhe i veçantë në tregun shqiptar**

Çdo shoqëri a dministruese e fondeve të pensioneve dhe e SIK-ve është e detyruar sipas ligjit të zgjedhë një bankë depozitare, të licencuar nga AMF-ja. Kjo bankë ka për detyrë të monitorojë respektimin e dispozitave ligjore dhe rregullative për fonde të


qeverisura nga ligji shqiptar. Fibank - Albania është e para dhe deri më tani, e vetmja bankë e licencuar nga AMF për të ushtruar funksionet e një banke depozitare për fondet e investimeve. Këtu sfida e Fibank, si bankë depozitare, është përmbushja me përpikmëri e të gjitha kërkesave të ligjit, duke iu përshtatur strukturave të veçanta që mund të ketë një shoqëri që menaxhon fondet dhe që pasqyrohet në diversitetin e kërkesave që kjo e fundit ka. Fibank ushtron veprimtarinë e Depozitarit për të dy fondet e investimeve të menaxhuara nga Raiffeisen Invest, e para dhe e vetmja SIK në Shqipëri e licencuar nga AMF. Falë infrastrukturës bashkëkohore dhe një stafi të përgatitur dhe të përkushtuar, kjo sfidë është kaluar me sukses dhe tashmë, në kujdestarinë e Fibank, menaxhohen rreth 22,500 llogari klientësh të fondeve të pensioneve dhe të investimeve me një total aktivesh prej mbi 29 miliardë lekë.

Së bashku me ruajtjen e aktiveve, administrimin e llogarive të posaçme për aktivet e një SIK-je, banka depozitare ndihmon dhe në blerjen dhe shitjen e aktiveve në emër të investuesit. Ajo gjithashtu duhet të sigurojë

se çdo aktiv i blerë, është në përputhje me prospektin e fondit dhe këtu përfshihet edhe siguria se çdo pasuri e blerë është marrë realisht, dhe gjithashtu kontabilizuar siç duhet në llogarinë e investuesit. Njëkohësisht, banka depozitare kujdeset për transferimin siç duhet të një aktivi të pronari i ri, kur investuesi zgjedh të shesë letrat me vlerë, ose një nga llojet e tjera të pasurive që janë besuar në bankë.

Banka Depozitare është një pjesë e rëndësishme e zinxhirit të SIK-ve, pasi është pikërisht ajo që garanton se llogaritja e vlerës neto të aksioneve ose të kuotave në fond është shpallur në përputhje me ligjin, rregulloret përkatëse të AMF-së, prospektin dhe rregullat e fondit. Llogaritja e vlerave neto të aktiveve dhe çmimit për njësi, bëhet çdo ditë në mënyrë të pavarur nga depozitari dhe shoqëria administruese dhe mund të publikohet nga kjo e fundit vetëm pasi është kuadruar nga të dy palët. Depozitari vepron vetëm në interes të mbajtësve të kuotave të fondeve dhe aksionarëve të shoqërive të investimit, për të cilët ai kryen veprimtarinë si depozitar e në respektim të këtij parimi bazë, është i detyruar t'i raportojë AMF-së për çdo shkelje të këtij ligji dhe të kontratës nga shoqëria administruese.

Tregu bankar shqiptar është tashmë i gatshëm dhe ka eksperiencën t'u ofrojë klientëve mundësi të reja për menaxhimin më me efektivitet të aktiveve të tyre, kurse klientët janë të gatshëm të përzgjedhin midis produkteve të reja dhe cilësore që iu propozohen nga bankat. Baza ligjore mundëson dhe garanton një proces transparent dhe të mirëkontrolluar. Sfidë është që kjo formë e re investimi dhe administrimi të ofrohet tek investuesit edhe nga aktorë të tjerë bankarë, duke mundësuar në këtë mënyrë më shumë opsione zgjedhjeje për klientët.



## ZGJIDHJA E ÇËSHTJES SË HUAVE ME PROBLEME NË MAL TË ZI



nga **Z. Nebojša ĐOKOVIĆ MSc**  
Këshilltar në Shoqatën e Bankave të Malit të Zi

Huat me probleme kanë qenë një tipar i përgjithshëm i sistemeve bankare të rajonit të Ballkanit gjatë viteve të fundit, veçanërisht që nga shpërthimi i krizës globale ekonomike e financiare të vitit 2008. Çështja e huave me problemeve nuk e kurseu as sistemin bankar malazez, problem ky që u vu në qendër të vëmendjes së strukturave drejtuese të bankave tregtare dhe autoritetit monetar si dhe të qeverisë së Malit të Zi. Në mesin e vitit 2011, huat me probleme arritën nivelin më të lartë të tyre, me rreth 26% (pas një periudhe disavejçare të boom-it së huadhënies në Mal të Zi). Kështu, në gjysmën e dytë të po atij viti, nisi programi i “pastrimit” të tyre, që u mbështet fort nga bankat mëmë (pjesa më e madhe e bankave në Malin e Zi zotërohen nga të huajt) apo shoqëritë e faktoringut, duke ulur nivelin e huave me probleme nën 15%. Megjithatë, nga mesi i vitit 2012, huat me probleme u rritën sërish, për shkak të vështirësive që hasën bankat mëmë në tregjet e tyre të brendshme. Një nivel i lartë i huave me probleme automatikisht kufizon aktivitetin huadhënës të bankave, efektet negative të të cilit pasqyrohen dhe në shoqëritë ekonomikisht të shëndosha. Për më tepër, këto shoqëri shfaqin probleme

“Modeli Podgorica” do t’u sigurojë jo vetëm bankave një mekanizëm eficient në zgjidhjen e problemeve, por gjithashtu, do të ndihmonte shoqëritë me aftësi paguese, të cilat kanë vështirësi në kryerjen e aktivitetit të tyre.

të mëdha lidhur me likuiditetin dhe paaftësinë e tyre paguese rezulton gjithashtu në probleme likuiditeti për të gjithë ekonominë.

Sektori bankar malazez është huadhënësi kryesor; nga 50 debitorët më të mëdhenj nga sektori i korporatave, llogaritë e të cilëve janë ngrirë, rreth 61% e përfaqësojnë huat (borxhet) ndaj sektorit bankar. Duke iu referuar të dhënave të fundit të Bankës Qendrore të Malit të Zi (CBCG), huat totale dhe llogaritë e tjera të arkëtueshme, për gjashtë muajt e parë të vitit 2013, u rritën me 4.9 % kundrejt fundit të vitit të mëparshëm, rritje që erdhi kryesisht si rezultat i ndryshimeve rregullatore. Konkretisht, si pasojë e zbatimit të Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit, bankat kthyen një pjesë të llogarive të arkëtueshme

Sfida kryesore është ende ajo e zvogëlimit të raportit të huave me probleme, kryesisht nëpërmjet zbatimit të projektit të quajtur “Modeli Podgorica”, që synon të ofrojë, në periudhë afatgjatë, efekte pozitive për rimëkëmbjen e ekonomisë së Malit të Zi, të zvogëlojë rreziqet për stabilitetin financiar dhe të krijojë donatorë fiskalë cilësorë.

dhe huave të fshira nga zëra jashtë bilancit në zëra të bilancit. Megjithatë, përpos përpjekjeve të bankave për të ristrukturuar portofolet e huave, rreziku i besueshmërisë është ende i pranishëm në nivele të moderuara. Në të kaluarën, bankat kanë marrë masa për të përmirësuar cilësinë e portofolit të huave, duke transferuar huat me probleme në bilancet e bankave mëmë, duke i shitur e ristrukturuar huat. Megjithatë, kushtet jo të favorshme ekonomike në mjedisin e krizës globale financiare ndikuan që niveli i huave me probleme të mbetej gjithashtu i lartë edhe në vitin 2013 (18% në fund të qershorit 2013, ndërkohë që pjesa e huave me probleme, sipas përmirësimeve rregullatore që hynë në fuqi më 1 janar të vitit 2013, llogaritet si përqindje e totalit të huave plus llogarive të tjera të arkëtueshme, minus interesat, parapagimet dhe interesat e konstatuar, ndaj totalit të huave dhe llogarive të tjera të arkëtueshme).

Rrjedhimisht, sfida kryesore është ende ajo e zvogëlimit të raportit të huave me probleme, kryesisht nëpërmjet zbatimit të projektit të quajtur “Modeli Podgorica”. Ky projekt, i cili mori shkas nga një marrëveshje e ngjashme e zbatuar në Turqi, nën emrin “Modeli i Stambollit”, u iniciua nga CBCG, në bashkëpunim me Ministrinë e Financave dhe Bankën Botërore, si dhe me kontributin e Shoqatës së Bankave të Malit të Zi. Projekti synon të ofrojë, në periudhë afatgjatë, efekte pozitive për rimëkëmbjen e ekonomisë së Malit të Zi, të zvogëlojë rreziqet për stabilitetin financiar dhe të krijojë donatorë fiskalë cilësorë.

Tipari kryesor i huave të dhëna për sektorin e korporatave në Malin e Zi

deri në  
**4,55%**

**Depozita  
në EURO**  
për më të mirën  
e interesit Tuaj



# Përvoja Franceze

për më të mirën e Shqipërisë

SE BASHKU FORCOJME SHPIRTIN E SKUADRES



**SOCIETE GENERALE  
ALBANIA**

Hapi i parë do të jetë miratimi i *Lex Specialis*, apo nënshkrimi i një marrëveshjeje shumëpalëshe midis Bankës Qendrore, bankave dhe shtetit. Kusht këtu është që të gjitha palët të jenë të gatshme për të bërë sakrificë.



është se ato janë të kolateralizuara me pasuri të paluajtshme, si forma më e parapëlqyer e garancisë, një mekanizëm ky i parapëlqyer nga shumica e bankave. Transferimi i të drejtave të pronësisë mbi pasuritë ka qenë një mënyrë mjaft popullore për të siguruar/garantuar huat. Megjithatë, pjesa më e madhe e bankave ende është në favor të përdorimit të garancisë hipotekore. Përsa u përket individëve, si kolateral përdoren gjithashtu dhe kambialet dhe garantuesit, së bashku me instrumentet e sipërpërmendur. Praktika ka treguar se arkitëtimi i huave me probleme nëpërmjet instrumenteve të tillë është mjaft i ngadalshëm e i ndërlikuar, madje shpesh i pasuksesshëm. Për më tepër, fillimi i procedurave të falimentimit nuk ka rezultuar për bankat si një mënyrë e shpejtë dhe efikase për zgjidhjen e problemeve, ndërkohë që projekti i ri shihet si një përpjekje për të zgjidhur problemet në mënyrë më eficiente, duke i dhënë mundësi të dyja palëve (bankave dhe debitorëve) të përmbushin interesat e tyre, në rastet kur debitori ende mund të vazhdojë veprimtarinë e tij dhe kur ka mundësi reale për të shlyer huan/t. Një shembull ilustrues është ai që tregon se, gjatë tre viteve të fundit janë regjistruar rreth 350 raste në vit për hapjen e procedurave të falimentimit, nga të cilat rreth 200 prej tyre mbyllen brenda vitit.

“Modeli Podgorica” (që është në fazën përfundimtare të përgatitjes) do t’u sigurojë bankave një mekanizëm mjaft efikas për të zgjidhur problemet e tyre; ai do të përshpejtojë marrjen e miratimit të gjykatës për planet e ristrukturimit, do t’i mbrojë ato nga rreziku transaksionit, si dhe do të sigurojë përfitime për pagesat e taksave, lidhur me fshirjen e borxheve dhe shitjen e pronave. Debitorët

do të kenë kushte të barabarta për negociim si dhe do të mund të rrisin bashkëpunimin me bankat. Përveç kësaj, ata do të kenë mundësi më të mëdha për të marrë hua, si dhe përmirësim në gradën e klasifikimit të besueshmërisë, lehtësira tatimore, mundësi për të ecur më shumë në biznes në të ardhmen si dhe për t’i mbajtur në treg shoqëritë e tyre. Projekti synon të ndihmojë shoqëritë me aftësi paguese, por që kanë disa vështirësi në aktivitetin e tyre, pra që kanë probleme likuiditeti. Modeli përcakton që marrëveshja mes palëve të kryhet mbi baza vullnetare, që përbën një përparësi shtesë, pasi ajo zvogëlon çfarëdo forme të trysisë nga cilado palë. Hapi i parë do të jetë miratimi i *Lex Specialis*, apo nënshkrimi i një marrëveshjeje shumëpalëshe midis Bankës Qendrore, bankave dhe shtetit. Kusht këtu është që të gjitha palët të jenë të gatshme për të bërë sakrificë, apo lëshime të caktuara. Bankat do të duhet të “fshijnë” një pjesë të normës së interesit si dhe të ulin normat e interesit, si dhe të zgjasin periudhën e shlyerjes së huasë. Shteti do të duhet të pranojë “fshirjen” apo shtyrjen e përmbushjes së një pjese të detyrimeve, në formën e taksave dhe kontributeve nga ana e shoqërive. CBCG-ja do të duhet t’i mbajë provizionet në të njëjtën kategori ose më lart dhe t’i vlerësojë në mënyrë më të favorshme provizionet e këtyre shoqërive, kur jepen hua të reja, që janë jetike për rimëkëmbjen e tyre. Shoqata e Bankave të Malit të Zi do të luajë një rol aktiv, nëpërmjet ndërmjetësimit dhe mbështetjes logjistike. Ristrukturimi i huave jashtë gjykatës ka shumë përparësi. Meqenëse procesi kryhet jashtë gjykatës, ai kërkon më pak formalitete (pra është një qasje fleksibël). Përveç kësaj, ajo ofron stimuj për debitorët që

ta raportojnë falimentimin në kohën e duhur, pasi nuk ka ndryshime automatike në ekipin drejtues të debitorit, nuk kryhet asnjë emërimtë administratorit të falimentimit, si dhe paraqet rrezik më të ulët nga likuidimi.

Hapi i parë drejt zbatimit të “Modelit Podgorica” është hartimi i një liste të shoqërive/sipërmarrësve të mundshëm. Negociatat për ristrukturimin do të zgjasin maksimumi deri në 90 ditë. Nëse 75% e huadhënësve (bazuar në vlerën totale të huave) bien dakord mbi modelin e ristrukturimit të propozuar, ai bëhet i detyrueshëm edhe për huadhënësit e tjerë. Nëse modeli pranohet nga më shumë se 50% dhe më pak se 75% e huadhënësve, shoqëria shkon në arbitrazh; vendimi i arbitrazhit është i detyrueshëm. Nëse shoqëria është debitorë ndaj një banke të vetme, atëherë vendimi përfundimtar merret nga ajo bankë. Në afatgjatë, nga zbatimi i suksesshëm i një modeli të tillë do të përfitojnë të gjithë pjesëmarrësit: bankat – pasi ato do të mund të arkëtojnë një pjesë të konsiderueshme të fondeve, në vend të fshirjes së llogarive të arkëtueshme; shteti – në treg do ketë shoqëri të afta të përmbushin detyrimet e tyre në të ardhmen dhe Banka Qendrore – pasi do të forcohet stabiliteti financiar.

Aktualisht, projektligji për ristrukturimin vullnetar të borxheve, është në hartim e sipër, nga Grupi i Punës që përbëhet nga përfaqësues të disa institucioneve (CBCG, Gjykata Tregtare, disa ministri, Shoqata e Bankave të Malit të Zi me ndihmesën e ekspertëve të Bankës Botërore). Në këtë proces janë angazhuar, pas miratimit nga ana e bankave, edhe këshilltarë të huaj, që u ofrojnë ndihmesë teknike bankave, në funksion të zgjidhjes së të gjitha rasteve individuale.

## PARTNERITETET PUBLIK-PRIVAT (PPP) DHE RAPORTIMI FINANCIAR<sup>1</sup>

Ndonëse në Shqipëri ende nuk ka një udhëzim të qartë për kontabilizimin dhe raportimin nga entet e sektorit publik lidhur me pasurinë subjekt i marrëveshjeve koncensionare, një ndihmesë në këtë drejtim mund të jetë mbështetja në kuadrin e IASB-se në standardin e marrëveshjeve të qirasë dhe sugjerimet e Bordit të IPSAS.

nga **Prof. Asoc. Dr. Hysen ÇELA**  
Kryetar i Këshillit Drejtues, IEKA



**Z. Kledi KODRA, FCCA**  
Udhëheqës i Departamentit të Auditimit,  
PwC - Shqipëri

### Përfitimet e pritshme të ardhshme ekonomike ose potenciali i shërbimeve.

Edhe pse ofruesi në një marrëveshje mund të kontrollojë përdorimin e pasurisë, për të plotësuar përkufizimin e një aktivi sipas IPSAS 1, siç u përmend më lart, prona duhet të sjellë një rrjedhë të pritshme të perfitimeve ekonomike të ardhshme ose potencial shërbimesh për ofruesin. KIRFN 12 konkludon se përdorimi i pasurisë, subjekt i këtyre marrëveshjeve, që rregullohen nga ky interpretim, nuk kontrollohet nga operatori (pra nuk plotëson përkufizimin e një aktivi për operatorin). KIRFN 12 mbulon vetëm kontabilitetin për operatorin privat dhe nuk adreson rrjedhën e perfitimeve nga pasuria tek ofruesi. Aspekti i potencialeve të shërbimeve si perfitime të ardhshme që mund të vijnë nga një aktiv është dallimi kryesor ndërmjet përkufizimit të një aktivi sipas IPSAS 1 dhe atij sipas kuadrit të BSNK, i cili përqendrohet vetëm në perfitimet e ardhshme ekonomike.

“Potenciali i shërbimeve” shpjegohet më tej në Paragrafin 11 të IPSAS 1, si vijon: Aktivet ofrojnë mjete për njësitë që të arrijnë objektivat e tyre. Aktivet që përdoren për të dhënë të mira dhe shërbime në përputhje me objektivat e një njësie ekonomike, por që nuk gjenerojnë drejtpërdrejt rrjedha monetare neto përshkruhen

Propozimet aktuale nga Bordi i IPSAS-eve, që mund të zbatohen si praktikë dhe në Shqipëri, sugjerojnë që ofruesi i koncensionit duhet të raportojë aktivin në pasqyrat financiare të tij, nëse ai konsiderohet që kontrollon pronën, për qëllime të raportimit financiar.

shpesh që përmbajnë “potencial shërbimi”. P.sh.: një rrugë ku nuk ngarkohen tarifa për kalim konsiderohet si aktiv për qeverinë, pasi jep shërbimet në mënyrë që të realizojë objektivat e qeverisë lidhur me transportin, edhe pse nuk prodhon perfitime ekonomike të ardhshme për të. Përgjithësisht, qeveritë hyjnë në marrëveshje të tilla koncensionare për të përmbushur objektivat e shërbimit nëpërmjet ndërtimit, rinovimit, ose përmirësimit të pasurisë, subjekt i marrëveshjes. Kështu, pasuria subjekt i kontratës ka për qëllim të ofrojë perfitime për ofruesin, që lidhen me potencialin e shërbimeve të tyre edhe nëse prona nuk siguron ndonjë perfitim të ardhshëm ekonomik. Edhe

pse motivi kryesor i ofruesit për të hyrë në një marrëveshje të tillë është perfitimi ekonomik, p.sh., për të marrë një rrjedhë paraprake mjeteshe monetare në këmbim të të drejtave për të operuar një rrugë, pasuria në themel të marrëveshjes do të vazhdojë të përdoret për të realizuar objektivat qeveritare – ajo vetëm do të operohet nga operatori privat, kështu që do të ofrojë perfitime nga potenciali i shërbimeve të saj për ofruesin.

P.sh., le të konsiderojmë një rrugë kombëtare pa tarifa që raportohet si aktiv nga ofruesi, bazuar në potencialin e shërbimeve të saj. Supozojmë që kjo rrugë bëhet objekt i një marrëveshje koncensionare (MK), sipas të cilës operatorit i jepet e drejta të vendosë tarifat për përdoruesit e rrugës, në këmbim të marrjes së përgjegjësisë për të kryer riparimet dhe rinovimet, si dhe të vërë në përdorim rrugën sipas specifikimeve të ofruesit. Nëse provohet që, sipas kontratës, ofruesi ka kontroll mbi atë rrugë, atëherë ai do të ketë të njëjtat perfitime që kishte përpara ekzekutimit të një marrëveshjeje të tillë. Kjo, pavarësisht se ofruesi ka kaluar një pjesë të mirë të rreziqeve dhe perfitimeve tek operatori. Prandaj duket që rruga duhet të vazhdojë të paraqitet si një aktiv i ofruesit, pasi nuk ka ndryshuar baza që kërkon raportimin e saj si aktiv, pra ajo është një pasuri e ofruesit.

<sup>1</sup> Vijon nga numri i kaluar.

sit bazuar në potencialin e shërbimit. Më tej, mund të argumentohet se kur ofruesi kontrollon pasurinë, operatori thelbësisht operon pasurinë në emër të ofruesit, në këtë rast ai është një furnitor shërbimesh për ofruesin e koncesionit. Rreziqet ekonomike dhe përfitimet e marra përsipër nga operatori nëpërmjet MK-së mund të jenë të ngjashme me ato të një shitësi në një kontratë shërbimi. Ato janë të ndryshme nga rreziqet dhe përfitimet që lidhen me pronësinë e kësaj pasurie. Megjithatë rreziqet ekonomike dhe përfitimet mund të jenë të lidhura me një aktiv të raportuar nga operatori privat, si rrjedhojë e "aksesit" në këtë pasuri. P.sh., operatori mund të raportojë një aktiv jomaterial, sipas KIFRN 12, sepse arkëtimet në të ardhmen varen nga përdorimi publik i shërbimit.

Propozimet aktuale nga Bordi i IPSAS-eve, që mund të zbatohen si praktikë dhe në Shqipëri, sugjerojnë që ofruesi i koncesionit duhet të raportojë aktivin në pasqyrat financiare të tij, nëse ai konsiderohet që kontrollon pronën, për qëllime të raportimit financiar. Kriteret e propozuara për përcaktimin e kontrollit nga ana e ofruesit janë që ofruesi kontrollon: (1) çfarë shërbimesh duhet të japë operatori, lidhur me pasurinë subjekt i MK-së, kujt duhet t'ia ofrojë këto shërbime, çmimet që lidhen me këto shërbime etj., (2) përmes pronësisë, apo përmes ndonjë shkakut tjetër, interesin e mbetur në pasuri, në fund të kohës së MK-së. Sipas Bordit, kontrolli i ofruesit mbi pasurinë në themel të marrëveshjes, provon se ai mbetet përgjegjës për ofrimin e drejtpërdrejtë apo të tërthortë të shërbimeve ndaj publikut, të cilat lidhen me atë pasuri. Mbajtja e rreziqeve dhe përfitimeve prej ofruesit tregon se ky i fundit pret të marrë nga pasuria mundësi shërbimi në të ardhmen.

#### Aspekte të tjera të kontabilitetit

Për MK-të që plotësojnë kriteret e propozuara të kontrollit, është praktikë e mirë të përdoren kërkesat e IPSAS 7, lidhur me momentin e njohjes së aktivit (gjatë ndërtimit apo vetëm kur aktiviteti bëhet i shfrytëzueshëm) dhe të detyrimit që lidhet me këtë aktiv, që në fakt pasqyron detyrimin e ofruesit për të kompensuar operatorin, lidhur me pasurinë (aktivin). Kriteret e njohjes përmbushen gjatë ndërtimit, nëse vlera e ndërtimit në proces, deri në atë moment, mund të matet në mënyrë të besueshme. Kjo vlen kur ofruesi mban rrezikun e ndërtimit, ose kur të dyja palët mund



të heqin dorë nga marrëveshja kur ato duan ta bëjnë një gjë të tillë dhe pa u penalizuar. Nëse asnjëri prej këtyre skenarëve nuk plotësohet, atëherë kriteret e njohjes nuk ka të ngjarë të plotësohen, derisa të përfundojë plotësisht ndërtimi. Gjithashtu, përcaktohen kërkesa të veçanta lidhur me marrëveshjet ku elementët e ndërtimit dhe ato të shërbimit mund të ndahen (ose jo), brenda pagesave të planifikuara nga ofruesi.

#### Raportimi financiar i ofruesit kur nuk përmbushen kërkesat e propozuara të kontrollit

Nëse për disa MK nuk plotësohet asnjë prej kriterëve të sipërpropozuara të kontrollit, ofruesi nuk duhet të njohë si aktiv, pasurinë në themel të kësaj marrëveshjeje. Rrjedhimisht, çdo pagesë që bëhet për këtë MK është për shërbimin e saj dhe jo për pasurinë/pronën, prandaj duhet të shpenzohet sipas realizimit të përfitimeve ekonomike të shërbimit. Gjithashtu, nëse prona ekziston dhe mbahet si aktiv nga ofruesi, sipas IPSAS 17, ajo duhet të ç'regjistrohet.

Për MK-të, në të cilat ofruesi vetëm kontrollon përdorimin e pasurisë gjatë marrëveshjes (si p.sh.: në MK të formës BOO - ndërtim-zotërim-operim), për qiramarrësin duhet të ndiqen udhëzimet në IPSAS 13, nëse MK-ja plotëson kushtet e një kontrate qeraje. Nëse ofruesi kontrollon vetëm përdorimin e pasurisë gjatë marrëveshjes dhe kjo nuk plotëson kushtet e një qeraje financiare, pasi ofruesi ruan pronësinë gjatë kohës së marrëveshjes, atëherë ofruesi duhet ta raportojë pasurinë si aktiv.

Nëse marrëveshja përfshin një pronë të ndërtuar rishtas, prona dhe detyrimi që lidhet me të do të raportohen dhe maten siç përshkruhet më sipër, lidhur me raportimin financiar të ofruesit, kur plotësohen kriteret e kontrollit. Në fund të MK-së, vlera kontabël e mbetur e pronës do të ç'regjistrohet, duke pasqyruar transferimin e pronës te operatori. Nëse marrëveshja nuk plotëson kushtet e një qeraje financiare dhe ofruesi nuk është pronar i pasurisë, atëherë ajo nuk do të regjistrohet si aktiv dhe çdo pagesë lidhur me këtë pronësi/aktiv do të përbënte një shpenzim të periudhës.

MK-të që lidhen me aktivitet/ pronat e saponduara, ku ofruesi nuk kontrollon përdorimin e aktivitet/pronës gjatë marrëveshjes, por në vend të tij kontrollon interesin e mbetur te ky aktiv/pronë në fund të marrëveshjes (p.sh.: marrëveshje të formës BOOT), ofruesi raporton si aktiv plus vlerën që krijohet nga diferenca mes vlerës së drejtë të pritshme të pronës në fund të MK-së dhe shumës që ofruesi do të kërkohej t'i paguajë operatorit, për rikthimin e pronës. Ky aktiv e arrin vlerën e tij në kontabilitet gradualisht me pagesat e bëra nga ofruesi te operatori gjatë gjithë jetës së marrëveshjes. Për MK-të që përfshijnë pasuritë ekzistuese, në të cilat ofruesi nuk kontrollon përdorimin e pronës gjatë kohës së marrëveshjes, por në vend të kësaj kontrollon interesin e mbetur në fund të marrëveshjes, Bordi propozon që të ndiqet udhëzimi që zbatohet për qeradhënsit, sipas IPSAS 13, nëse

**Deri tani nuk mund të ndodheshe  
në dy vende, në të njëjtën kohë.**

**winbank**



Ogilvy & Mather Albania

## **Tani mundesh me winbank!**

Vizitoni winbank nga Tirana Bank në çdo çast, kudo që ndodheni, nëpërmjet platformës elektronike të Grupit Bankar të Pireut të vlerësuar me çmime! Kryeni veprime bankare të sigurta 24 orë në ditë, duke kursyer kohë nga laptop-i, smartphone-i ose nga telefoni juaj nëpërmjet:

> [www.tiranabank.al](http://www.tiranabank.al) > 0800 6868 ose 04 22 77 700

Regjistrohuni tani në një nga degët tona dhe përfitoni winbank falas!

**TIRANA  
BANK**  
tani mundesh

PIRAEUS BANK GROUP



marrëveshja plotëson përkufizimin e një kontrate qeraje. Nëse marrëveshja nuk plotëson këtë përkufizim, ofruesi e çregjistron nga aktivi pronën dhe njuh si aktiv detyrimin e operatorit për të kthyer pronën në fund të marrëveshjes.

### Dispozitat për ndarjen e të ardhurave

Për ato MK ku operatori parashikohet të grumbullojë të ardhura nga tarifat drejtpërdrejt nga palët e treta, ose nga përdoruesit e të mirës publike, ofruesi zakonisht negocion që në kontratë të përfshijë një dispozitë për ndarjen e këtyre të ardhurave midis tij dhe operatorit. Kështu, nëse përdorimi i pronës tejkalon parashikimet, atëherë operatori suksesin do ta ndajë me ofruesin. Kjo dispozitë shërben për të mbrojtur ofruesin nga rreziku politik dhe kritikak publike, që mund të bëhen për përfshirjen në një marrëveshje, që mund të jetë shumë fitimprurëse për një operator privat. P.sh., si pjesë e një marrëveshjeje BOOT për ndërtimin e një parkingu të madh, ofruesi merr një honorar fiks për çdo biletë të shitur. Ofruesi e përdor këtë honorar për të financuar

Për MK-të që plotësojnë kriteret e propozuara të kontrollit, është praktikë e mirë të përdoren kërkesat e IPSAS 7, lidhur me momentin e njohjes së aktivitet (gjatë ndërtimit apo vetëm kur aktivi bëhet i shfrytëzueshëm) dhe të detyrimit që lidhet me këtë aktiv, që në fakt pasqyron detyrimin e ofruesit për të kompensuar operatorin, lidhur me pasurinë (aktivin).

veprimtari të komunitetit. Gjithashtu, në një marrëveshje që përfshin ndërtimin e një rruge ku kalimi bëhet me pagesë, ofruesi ka të drejtë të marrë 40% të të ardhurës totale, pasi flukset neto nga marrëveshja arrijnë t'i ofrojnë operuesit një normë kthimi para tatimit prej 6.5% mbi fondet totale të investuara. Pjesa e ofruesit rritet në 80% e të ardhurës totale të mbledhur, pasi flukset e kontratës i japin operatorit një normë kthimi prej 8%.

Dispozitat e ndarjes së të ardhurave shpesh përfshihen në kushtet e një marrëveshjeje, së bashku me një garanci minimale për operatorin. P.sh.:

një marrëveshje për operimin e një autostrade me pagesë përmban një dispozitë për ndarjen e të ardhurave. Kjo dispozitë kërkon që ofruesi të përftojë rreth 57% të të ardhurave që kalojnë ato të parashikuara. Kjo dispozitë mund të jetë e shoqëruar nga një dispozitë tjetër ku ofruesi do të paguajë 80% të çdo difference mes të ardhurave të parashikuara krahasuar me ato aktuale. Kështu, ofruesi minimizon rrezikun e kërkesës, duke i dhënë operatorit një lloj garancie për minimum e të ardhurave, të cilat nëse projekti rezultojnë i suksesshëm kanë potencialin të jenë edhe më të mëdha. Propozimet aktuale të Bordit theksojnë se ofruesit duhet t'i njohin këto të ardhura (dhe të arkëtueshmet), ashtu siç ato fitohen, pra në linjë me thelbin e marrëveshjes dhe pasi është përmbyllur ndonjë ngjarje potenciale (si p.sh.: tejkalimi i pragut të minimumit të të ardhurave).

### Konsolidimi

*Ndërmarrjet qeveritare të biznesit*

Kur operatori është një ndërmarrje e biznesit qeveritar, gjithmonë do të ekzistojnë disa nga treguesit e kontrollit të trajtuara në paragrafet 39 dhe 40 të IPSAS 6, veçanërisht nëse kjo lloj ndërmarrje krijohet që të shërbejë si operator në këto MK. Përgjithësisht, ky operator duhet të konsolidohet në pasqyrat financiare të ofruesit.

*Njësitë ekonomike për qëllime të veçanta (SPV)*

Operatori në këtë rast është një njësi ekonomike për qëllime të veçanta

(SPV) dhe treguesit e kontrollit të përshkruara në paragrafin 39 të IPSAS 6 nuk janë të vlefshme në marrëdhëniet ndërmjet operatorit dhe ofruesit. Megjithatë, termat kontraktuale të këtyre marrëveshjeve mund të rezultojnë në prani të disa prej treguesve të kontrollit, të dhëna në paragrafin 40 të IPSAS 6. P.sh.: në një SPV, që krijohet për një rrugë me pagesë, dispozitat e mëposhtme të kontratës mund të jenë tregues i fuqisë kontrolluese të ofruesit mbi operatorin:

- Operatorit i lejohet marrja e borxhit, siç specifikohet në kontratë dhe ofruesi duhet të miratojë paraprakisht çdo borxh shtesë.
- Të gjitha tarifat e pagesave për kalimin e rrugës janë subjekt i miratimit nga ministri i Transporteve dhe mund të ndryshojnë nga kërkesa e ofruesve.
- Ofruesi mund të kërkojë që të hiqet nga puna çdo punonjës që është p.sh.: i paafhtë, i pasjellshëm ose jokompetent etj..

Dispozitat e marrëveshjes në këtë shembull, që mund të tregojnë se ofruesi merr përfitime nga aktivitetet e operatorit janë si më poshtë:

- Nevojitet që operatori të sigurojë që autostrada do të jetë e hapur për trafikun në çdo kohë dhe se rrjedha e trafikut përmbyll standarde të paracaktuara, që plotësojnë objektivat e ofruesit lidhur me transportin.
- Operatori do të bëjë pagesa ndaj ofruesit, nëse kthimi i projektit tejkalon një kufi të caktuar.



## MASAT MAKRO-PRUDENCIALE DHE STABILITETI FINANCIAR, NËN OPTIKËN E BAZEL III



nga Prof. Dr. Adrian CIVICI  
President & Drejtor  
i Shkollës Doktorale  
Universiteti European i Tiranës, UET

Sa më shumë që njihen shkaqet dhe mekanizmi që shkaktoi krizën financiare globale, aq më shumë këmbëngulet në shtimin e rregullave dhe mekanizmave që garantojnë stabilitetin financiar dhe sektorin bankar. Liberalizimi financiar, i filluar në fund të viteve '80, e rriti ndjeshëm destabilizimin e sistemit financiar, duke reduktuar dhe kapacitetet e tij për t'i rezistuar goditjeve dhe absorbuar çekuilibrat. Për të mbrojtur bankat nga rreziku sistemik, si dhe për të zvogëluar rreziqet e një krize bankare që mund të infektonte si sistemin financiar ashtu dhe ekonominë reale, u adoptuan njëra pas tjetrës Marrëveshjet e Bazel I dhe Bazel II. Në vitin 1988, Komiteti i Bazelit përgatiti dhe publikoi tërësinë e kërkesave për bankat në kuadrin e "Cooke ratio", ku theksi u vu në rrezikun e besueshmërisë dhe sasinë e kapitalit dhe aktiveve që bankat duhej të kishin, për t'i bërë ballë humbjeve të mundshme. Në vitin 2004, Bazel II propozoi "McDonough ratio", që e zgjeronte gamën e rreziqeve dhe përsoste metodën e llogaritjes së koeficientëve të peshimit të rrezikut.

### Çfarë na garanton Bazel III?

Kriza financiare, e filluar që në vitin 2007, dëshmoi se rregullimet me natyrë mikro-prudenciale ishin të pam-

Marrëveshja Bazel III, e publikuar që në 16 dhjetor 2010, propozon një seri politikash makro-prudenciale, që bazohen në një kuptim më të plotë të rrezikut sistemik dhe elementeve të destabilitetit financiar.

jaftueshme për të garantuar objektivat e mësipërme. Rregullimet ekzistuese me natyrë mikro-prudenciale, në vend të eliminonin rrezikun sistemik, rrezikonin ta amplifikonin atë. Megjithë konsensusin që ekzistonte se, "sistemi i rregullimit financiar duhej të pajisej me mekanizma eficientë për zbulimin e rrezikut sistemik dhe administrimin e tij, në fakt nuk u arrit dot të përcaktoheshin natyra dhe përmasat e treguesve që shprehin këtë rrezik", aq më tepër të përcaktohej dhe matej efekti zinxhir që shërbimet financiare mund të shkaktonin në gjithë sistemin financiar, ekonominë reale dhe rritjen ekonomike, mirëqënien sociale, etj.

Bazel I dhe Bazel II, pikërisht për shkak të karakterit të tyre mikro-prudencial, shfaqën një sërë dobësish, të tilla, si: 1) nuk penalizojë përqendrimi i portofoleve vetëm në disa angazhime të caktuara, bile peshimi i rrezikut, nxiste përqendrimin e portofoleve në aktive me rrezik të ulët (si: bonot e thesarit të qeverive të ndryshme, huat hipotekore, huat ndërbankare etj) dhe përdorimin masiv të produkteve derivate të tipit CDS (credit default swap), që e maskonin nivelin e rrezikut, në mënyrë që të justifikonin nevojën për kapitale shtesë; 2) duke përdorur vetëm treguesin e rrezikut global unik, modelat matematikore e ekonometrike injoronin ndikimin e rrezikut specifik të një vendi të veçantë, në rrezikun global dhe shkallën e ekspozimit të mjaft institucioneve e tregjeve ndaj këtij rreziku; 3) mosmarrja sa duhet

në konsideratë të rrezikut që merrnin institucionet financiare në veprimtarinë e tyre në treg, sidomos titullizimin e huave dhe veprimet jashtë bilancit, duke i ekspozuar shumë këto institucione përballë krizave të likuiditetit; 4) rregullimi i kapitaleve ishte pro-ciklik, në masën që rreziku nënvlerësohet në periudha ekspansioniste dhe mbivlerësohet në periudha recesioni, ndërkohë që vlerësimi i aktiveve duhej të bazohej në vlerën e tyre të tregut. Pra, vlerësimi i rrezikut bëhej në një moment të dhënë dhe jo kundrejt gjithë ciklit, duke rrezikuar eficiencën e politikave rregulluese.

Në këtë kontekst, në mjediset bankare e financiare u krijua konsensus i

Dispozitivi i rregullimit makro-prudencial evidenton si objektiv themelor "garantimin e stabilitetit të sistemit financiar në tërësinë e tij, u imponon autoriteteve rregulluese përmirësimin dhe kompletimin e analizës së rrezikut për atë sistemik dhe u kërkon atyre të kenë në dispozicion instrumentet e nevojshme për trajtimin e këtij rreziku".


plotë “për nevojën e një rregullimi financiar me përmasa makro-prudenciale”. Pjesa kryesore e tyre duhej të integrohej menjëherë në marrëveshjen e radhës, Bazel III, duke lënë një periudhë zbatimi që shtrihet deri në vitin 2019. Megjithatë, në radhët e ekspertëve të tregjeve financiare dhe bankierëve pikëpyetja mbetet: a mjaftojnë masat makro-prudenciale në kuadër të Bazel III, për të parandaluar kriza të mëdha financiare në të ardhmen?

### Politikat makro-prudenciale.

Dispozitivi i rregullimit makro-prudencial evidenton si objektivi themelor “garantimin e stabilitetit të sistemit financiar në tërësinë e tij, ju imponon autoriteteve rregulluese përmirësimin dhe kompletimin e analizës së rrezikut në tërësinë dhe ju kërkon atyre të kenë në dispozicion instrumentet e nevojshme për trajtimin e këtij rreziku”. Ndryshe nga vizioni mikro-prudencial, që privilegjon ekuilibrin pjesor apo rezistencën individuale të institucioneve financiare, vizioni makro-prudencial privilegjon ekuilibrin e përgjithshëm dhe kërkon arritjen e një stabiliteti financiar global, synon zbulimin dhe parashikimin e shfaqjes së krizave sistemike, e mbi të gjitha, pengimin e shndërrimit të tyre në kriza financiare. Politikat makro-prudenciale, përveç objektivit të tyre, karakterizohen dhe nga dy elemente të tjerë: 1) fusha e tyre e veprimit, që është sistemi financiar në tërësinë e tij, përfshirë këtu dhe lidhjen ndërmjet sferës financiare dhe ekonomisë reale; 2) lloji specifik i instrumenteve, fusha e veprimit dhe mënyrat specifike të përdorimit të tyre. Sa më shumë njihet sistemi financiar dhe mënyra e “sjelljes” së tij, aq më të larmishme bëhen instrumentet dhe politikat rregulluese e mbikqyrëse financiare.

Rreziku sistemik ka prirje të rritet pikërisht në momentin kur bankat dhe klientët e tyre e vlerësojnë sistemin si solid dhe të stabilizuar.

Rregullimet me natyrë makro-prudenciale kalojnë detyrimisht nëpërmjet analizës së rrezikut sistematik. Njohja sa më e plotë e elementëve të tij nga autoritetet makro-prudenciale, është elementi thelbësor për



identifikimin e rreziqeve që i kanojnë stabilitetit financiar. Për këtë, ekspertët e fushës kërkojnë bërjen e një dallimi sa më të qartë ndërmjet “dimensioneve të përkohshme” dhe “dimensioneve transversale” të këtij rreziku, që në evolucionin e tyre janë të lidhura ngushtë me njëra-tjetrën. Dimensionet e përkohshme pasqyrojnë formimin e rrezikut sistematik në kohë, pasojë e sjelljeve prociklike të institucioneve financiare, që manifestohet në shfaqjen e cikleve financiare. Është e rëndësishme të njihet se si ky rrezik amplifikohet nga ndërlikimet e sistemit financiar, si dhe ato ndërmjet këtij sistemi dhe ekonomisë reale. Shenjat që e paralajmërojnë këtë situatë shfaqen në formën e të ashtuquajturit “paradoksi i destabilitetit financiar”, sipas së cilit, sa më shumë që sistemi financiar duket i shëndoshë, aq më shumë ai është në rrezik. Rreziku sistemik ka prirje të rritet pikërisht në momentin kur bankat dhe klientët e tyre e vlerësojnë sistemin si solid dhe të stabilizuar. Perceptimi i një niveli të ulët rreziku krijon situata artificiale qetësie e besimi, në të cilat oferta e huas është e fortë, çmimet e aktiveve artificialisht të larta dhe fitimet shumë të mira. Pra, ajo që duket si thuasja pa rrezik, në fakt paraqet marrje përsipër të një rreziku të lartë.

Dimensioni transversal ka të bëjë me mënyrën e shpërndarjes së rrezikut të agreguar në sistemin financiar në një moment të dhënë, pra me lidhjet dhe ndërveprimet e institucioneve financiare me njëri-tjetrin. Në këtë rast, problemi bazë është pikërisht ekzistenca “e ekspozimit të korreluar të institucioneve financiare”, përballë rrezikut. Autoritetet rregullatore duhet të marrin në konsideratë tre faktorë kritikë, të cilësuar si më kryesorët në amplifikimin e

rrezikut në sistemin financiar: 1) niveli i lartë i efektit levë, që lidhet me përpjesëtimet ndërmjet angazhimeve financiare dhe nivelit të kapitalizimit për çdo bankë apo institucion financiar; 2) prirja për ekspozim dhe marrje përsipër e rrezikut nga institucionet financiare. Ka plot raste kur një rrezik individual duket i moderuar, por në fakt nuk rezulton i tillë, për pasojat që ai mund të shkaktojë në tërësinë e sistemit financiar; 3) kompleksiteti i jashtëzakonshëm i sistemit financiar, që karakterizohet nga një ndërthurje e madhe mes institucioneve financiare me njëri-tjetrin, nga diferenca kolosale në shkallën e angazhimit të tyre në treg, sidomos në momentin kur çmimet e aktiveve rriten. E gjithë kjo e rrit së tepërmi rrezikun e infektimit reciprok dhe për pasojë të të gjithë sistemit.

### Specifikat e instrumenteve makro-prudenciale.

Këto instrumente synojnë të kombinonjë efektet e dy dimensioneve të rrezikut sistematik, si dhe të adaptohen sa më mirë me dy fazat që karakterizojnë ecurinë e këtij rreziku. Gjatë fazës së akumulimit të rrezikut, këto masa “parandaluese” duhet të rrisin rezistencën e sistemit financiar dhe të kontrollojnë amplitudën e cikleve financiare, duke moderuar ofertën e huas, respektuar nivelet e kapitalizimit dhe likuiditetit etj. Në fazën e materializimit, ato duhet të zbusin çdo element të destabilitetit financiar dhe kufizojnë e axhustojnë shfaqjen e panikut. Një masë apo instrument, cilësohet dhe vlerësohet si makro-prudenciale në momentin që ajo lejon zvogëlimin e probabilitetit të formimit të një rreziku financiar sistematik. Specifikisht, për instrumentet që trajtojnë problematikën e ndërli-

 **SHTËPIAIME**

**KREDI PER SHTEPI**



 **UNIONBANK**  
Banka që dua

**Nuk është ëndërr!**

**6.3%** ne Euro, **3 vjet** interes fiks i pandryshuar  
**5.3%** ne Euro nga bashkepunimi me  
30 kompani serioze ndertimi

[www.unionbank.al](http://www.unionbank.al)  04 238 9111



dhjeve dhe ndërveprimit ndërmjet bankave, të uniformitetit të portofoleve apo funksionimit të sistemeve bankare paralele, termi makro-prudencial ka hapësirën e tij maksimale të veprimit.

#### Mbikëqyrja makro-prudenciale.

Paketa e masave të Bazeli III propozon një seri politikash e “detyrimesh” në kuadrin e rregullimit financiar kundërciklik, që besohet se do të japin efekte pozitive në sferën e stabilitetit financiar. Marrëveshja Bazeli III, e publikuar që më 16 dhjetor 2010, propozon një seri politikash makro-prudenciale, që bazohen në një kuptim më të plotë të rrezikut sistematik dhe elementeve të destabilitetit financiar. Objektivi i parë ka të bëjë me “zvogëlimin e prirjes së sistemit bankar për amplifikimin e luhatjeve të cikleve ekonomike, nëpërmjet një ofertë ekseseve të huave në fazat e qeta dhe zvogëlimin drastik të tij në fazat e tensionuara”. Kërkesat minimale për mjaftueshmërinë e kapitalit kalojnë nga 8% në 10.5%, duke shtuar këtu një instrument të ri makro-prudencial: futjen e një fondi të ri të detyrueshëm fleksibël kundërciklik në masën 0-2.5%. Bankat e ndërtojnë këtë fond kundërciklik në fazën rritëse të ciklit financiar, në mënyrë që ta përdorin atë në fazën zbritëse negative, duke eliminuar kështu efektet e ndërsjellta. Bankat e fillojnë ndërtime të këtij fondi në momentin kur

raporti hua/PBB kalon një nivel të caktuar të konsideruar si kritik dhe e përdorin këtë fond në rastet kur rezultojnë me humbje, apo kur oferta e huas ulet ndjeshëm.

Masë tjetër makro-prudenciale, që synon një mbikëqyrje më të mirë të efektit levë në institucionet financiare, që rrit rentabilitetin potencial të bankave, por shton njëkohësisht dhe mundësinë e humbjeve, është niveli i kapitalizimit në raport me aktivet e peshuara në funksion të shkallës së rrezikut. Bankat e mëdha autorizohen ta përcaktojnë vetë shkallën e rrezikut dhe koeficientët e peshimit. Ndërkohë, Bazeli III parashikon futjen e një tavani kufizues për efektin levë, duke kufizuar shumën totale të aktiveve që një bankë mund të zotërojë në funksion të kapitalit të saj. Ky instrument krijon mundësi për kufizimin e rrezikut të institucioneve financiare, megjithëse shumë nga bankat vazhdojnë të kundërshtojnë idenë e publikimit të efekteve levë të tyre.

Bazeli III parashikon dhe futjen e dy kriterëve të reja kufizuese për sa i përket likuiditetit, në mënyrë që t’i detyrojë bankat t’i përdorin aktivet e tyre në investime afatgjata jo likuide. Dy kriteret kufizuese i detyrojnë bankat që të ruajnë një rezervë minimale likuiditeti. I pari, është një përqindje likuiditeti afatshkurtër, që ju imponon bankave që të mbajnë një sasi aktivesh likuide për të mbuluar nevojat

e parashikuara në një periudhë një mujore; ndërkohë që i dyti është një përqindje që përcakton likuiditetin në periudha afatgjata, qëllimi i të cilit është garancia se bankat zotërojnë rezerva të mjaftueshme, për të mbuluar nevojat e tyre për një periudhë 12-mujore.

Bankat kanë kohë deri në vitin 2019 për të zbatuar tërësisht rregullat e Bazeli III, por Komiteti i Bazelit rekomandon se, ato duhet të fillojnë sa më shpejt përgatitjet dhe zbatimin e pjeshëm të tyre edhe përpara kësaj date. Megjithatë, në mjediset bankare e financiare dhe ato ekonomike në përgjithësi, ekziston dhe një debat i nxehtë lidhur me efektet anësore dhe pasojat që mund të kenë këto rregulla. Këtu mund të përmendim dyshimet dhe paqartësitë për çështjet që: a i përgjigjet si duhet kjo marrëveshje problematikës së lidhjeve ndërbankare, që është në origjinë të shumë elementeve të destabilitetit financiar; a është parashikuar si duhet “koordinimi ndërmjet politikave makro-prudenciale dhe politikave monetare”, duke arritur deri në propozime që kërkojnë një integrim sa më të plotë të këtyre dy politikave nën ombrellën e bankave qendrore; si do të jetë zgjedhja e instrumenteve të konsideruar si “më të përshtatshmet” nga autoritetet makro-prudenciale dhe cilat do të jenë limitet e fushës së tyre të veprimit etj.

## ALPHA BANK

### Alpha Gym Park

Prej disa kohësh pranë Liqenit Artificial të Tiranës, ka filluar të funksionojë palestra e parë në natyrë në Shqipëri. Ky projekt i rëndësishëm u mundësua nga Alpha Bank Albania me mbështetjen e Bashkisë Tiranë. Prej shumë vitesh Alpha Bank ka mbështetur aktivitete të ndryshme sportive, duke synuar të promovojë vlerat e sportit.

Që prej ditës së parë Alpha Gym Park është mirëpritur dhe frekuentuar rregullisht nga qytetarët, të cilët kanë pasur mundësinë të marrin këshilla për përdorimin e duhur dhe efikas të pajisjeve nga një instruktore fitnesi. Alpha Gym Park përmban 10 pajisje gjimnastikore, si edhe mjedis të përshtatshëm të rrethuar me gjelbërim, stola dhe çezma për t'u freskuar. Punonjësit e Alpha Bank mbollën disa pemë dhe gjatë javëve në vazhdim dhuruan bluza dhe çanta sportive, për të gjithë qytetarët që ushtrojnë aktivitetin e tyre fizik pranë këtij parku sportiv.

*Së bashku dhurojmë jetë!*

Alpha Bank Albania në bashkëpunim me Kryqin e Kuq Shqiptar, më datë 14 Qershor organizoi për të tretin vit radhazi, ditën e dhurimit vullnetar të gjakut nga punonjësit e Bankës. 14 Qershori është Dita Botërore e Dhurimit të Gjaktit dhe banka zgjodhi pikërisht këtë ditë për të përcjellë mesazhin, që dhurimi i gjakut është një veprimtari jetësore dhe duhet përqafuar nga të gjithë, duke u bërë dhurues të rregullt.

Gjatë aktivitetit, drejtori i Përgjithshëm i Alpha Bank Albania u shpreh se: "Me fillimin e kësaj tradite, Banka dëshiron të nënvizojë rëndësinë e të kuptuarit që është përgjegjësia jonë sociale të ndihmojmë njerëzit që kanë nevojë për ne." Ai falënderoi Kryqin e Kuq Shqiptar për fushatat e sensibilizimit që ata kanë ndërmarrë si edhe kolegët e Alpha Bank që, me anë të këtij akti, janë bërë shpëtimtarë të një jete.



## BANKA KOMBETARE TREGTARE

*BKT kontribuon në rritjen e kreditimit të bizneseve në Tiranë*

Në vijim të bashkëpunimit me qeverisjen vendore, si dhe në kuadër të përgjegjësisë sociale, me synim kontributin sa më të madh në zhvillimin e ekonomisë, rritjen e punësimit, si dhe rritjen e kreditimit, BKT firmosi "Programin e ri të Garancisë me Bashkinë e Tiranës". Nëpërmjet këtij programi garancie, Bashkia e Tiranës ka ofruar një fond prej 100 milionë Lekësh, në formën e një garancie, për të siguruar rrezikun që shoqëron huadhënien ndaj ndërmarrjeve mikro, të vogla dhe të mesme. Këto hua, përveç faktit se ofrohen me një normë interesi shumë preferenciale, do t'u jepen jo vetëm bizneseve ekzistuese dhe atyre të sapo hapura, por edhe bizneseve të palicensuara, që duan të zyrtarizojnë veprimtarinë e tyre.

*"Euromoney" konfirmon BKT si "Bankën më të mirë në Shqipëri" për vitin 2013*

BKT i shton një tjetër çmim koleksionit të vlerësimeve ndërkombëtare. Risitë në ofrimin e shërbimeve bankare dhe menaxhimi i suksesshëm financiar i kanë dhënë për të dytin vit radhazi çmimin: "Banka më e mirë në Shqipëri" për vitin 2013, nga revista prestigjioze financiare "Euromoney". Çmimi iu dorëzua kryetarit të Bordit Drejtues të Bankës, z. Mehmet Usta, dhe drejtorit të Përgjithshëm dhe anëtarit të Bordit të saj, z. Seyhan Pencablilil, në mbrëmjen e zhvilluar në Londër.



## ■ CREDINS BANK

*Credins Bank çeli sezonin turistik*

Credins Bank mbështeti çeljen e sezonit turistik në qytetin bregdetar të Sarandës dhe atë malor të Përmetit. Nën organizimin e drejtuesve vendorë, këto evente mblodhën shumë operatorë të turizmit vendas dhe të huaj, të cilët shkëmbyen ide dhe eksperiencë, për të gjeneruar më shumë interes dhe vizitorë. Potenciali për zhvillim që ofron bregdeti mahnitës i Jugut, apo peizazhet përrallore të zonave, si Përmeti, duhet të shërbejnë si katalizator të turizmit shqiptar.

Interesim i madh u shpreh nga operatorët e shërbimeve turistike, pjesëmarrës nga i gjithë rajoni i Jugut, në eventin e organizuar pranë mjedisëve të Bashkisë Sarandë, për shërbimin e-Commerce, që ofrohet nga Credins Bank. Ky shërbim do të afrojë biznesin shqiptar, deri te konsumatori më i largët, duke pranuar pagesa për rezervime/prenotime.



## ■ CREDIT AGRICOLE

*Përurohet stacioni i ri i biçikletave i Bankës Credit Agricole - Shqipëri*

Banka Credit Agricole - Shqipëri, në bashkëpunim me organizatën joqeveritare mjedisore Ecovolis, përuroi stacionin e biçikletave, pranë zonës së “21 Dhjetorit” në Tiranë. Në përrurim ishte drejtori i Përgjithshëm i Bankës z. Luc Beiso, dhe drejtori i Ecovolis, z. Ened Mato. Ky përrurim erdhi në vijim të aktiviteteve që Banka Credit Agricole Shqipëri, realizon në kuadër të përgjegjësisë sociale dhe në vijim të mbështetjes së bankës ndaj iniciativave qytetare dhe mjedisore në shërbim të komunitetit.

Stacioni i vendosur në zonën e “21 Dhjetorit”, zonë kjo me një nivel ndotjeje urbane të lartë, është një mesazh për komunitetin, për të ulur përdorimin e karburantit. Kjo përçohet dhe në mesazhin që banka transmeton nëpërmjet tabelave të vendosura në këtë stacion: “Mos digjini karburant, por kalori”. Në mbështetje të këtij aktiviteti të bankës ishte vetë stafi i saj dhe bashkëpunëtorë të ndryshëm, të cilët pedalojnë gjatë gjithë rrugës kryesore dhe në bulevardin “Nënë Tereza”.



## ■ FIRST INVESTMENT BANK

*Fibank, për të katërtin vit radhazi, sponsor i projektit Punësimi Sezonal i Studentëve*

Është kthyer në traditë bashkëpunimi i Fibank me Bashkinë e Korçës për projektin “Punësimi Sezonal i Studentëve”. Ceremonia e mbylljes së këtij projekti dhe certifikimit të studentëve pjesëmarrës u organizua në ambientet e Life Galery në qytetin e Korçës. Gjatë kësaj ceremonie u shpërndanë certifikata për të gjithë studentët, të lëshuara nga të dy këto institucione.

Ky projekt mbështetet çdo vit nga Fibank, pasi i kushtohet brezit të ri të këtij qyteti, punonjësve të ardhshëm në institucione e biznese të rëndësishme, pse jo punonjësit të ardhshëm të Fibank dhe padyshim klientët të mirë të saj. Bashkëpunimi me Bashkinë e Korçës cilësohet, si i suksesshëm për bankën, pasi krijon një lidhje më të qëndrueshme me qytetin e Korçës, si për studentët pjesëmarrës në projekt, ashtu dhe për familjet e të njohurit e tyre.



## INTESA SANPAOLO BANK - ALBANIA

*Live Art – Ekspozita e parë në Galerinë Kombëtare të Arteve*

Intesa Sanpaolo Bank Albania organizoi për herë të parë Konkursin e Pikturës në artin bashkëkohor, në bashkëpunim me Ministrinë e Kulturës dhe Galerinë Kombëtare të Arteve si partnerë zyrtarë. Konkursi mbërriti në fazën e tij finale, ku midis 26 finalistëve u shpallën 3 çmimet e para, më 30 shtator 2013.

Ceremonia e Hapjes dhe fjalimi u mbajtën nga z. Alexander Resch, ish drejtori i Përgjithshëm i Intesa Sanpaolo Bank – Albania, i cili theksoi përpjekjen e bankës për të forcuar urat lidhëse mes artit bashkëkohor shqiptar me atë ndërkombëtar, një përjasje globale me ngjyrimet lokale, përmes së cilës Intesa Sanpaolo Bank Albania fton në këtë udhëtim të përvitshëm përmes thënies së saj frymëzuese: Drejt të ardhmes me ju!

Eventi u nderua nga prezenca e Kryeministrit të Republikës së Shqipërisë, Z. Edi Rama, i cili e konsideroi këtë projekt një shprehje të rëndësishme të fuqisë artistike të Shqipërisë dhe shembull pozitiv të asaj që mund të arrihet në partneritet me sektorin privat. Ai shprehu dëshirën për të nxitur transformimin e këtij projekti në bienale ndërkombëtare të të rinjve.

Ekspozita qëndroi e hapur në mjediset e Galerisë Kombëtare të Arteve deri në 10 tetor 2013 dhe do të udhëtojë në Korçë, Vlorë, Shkodër e Durrës deri në fund të Janarit 2014.

*Gjuha e Shenjave Shqipe – Të zgjerohet mundësitë e komunikimit*

Intesa Sanpaolo Bank - Albania sponsorizoi botimin e dytë të librit të “Gjuhës së Shenjave Shqipe I” (Libër dhe Video) në 500 kopje, për t’u shërbyer personave që nuk dëgjojnë, që e përdorin këtë gjuhë në jetën e tyre të përditshme si dhe për familjet, mësuesit dhe miqtë e tyre. Ky është një prodhim i Shoqatës Kombëtare Shqiptare të Njerëzve që nuk Dëgjojnë (ANAD), publikuar për herë të parë në 2004. I munguar në treg për rreth 10 vjet, ky libër është një ndihmë e madhe për njerëzit me paafësi në dëgjim, por edhe për të gjithë ata që do dëshironin të mësonin gjuhën e shenjave për të komunikuar më lehtësisht me ta.

Përfaqësues të Bankës ishin prezent në ambientet e Institutit të Nxënësve që nuk Dëgjojnë, në Tiranë, më 27 Shtator, në aktivitetin e organizuar me rastin e Javës Ndërkombëtare të Njerëzve që nuk Dëgjojnë (23 -29 shtator), për të dorëzuar këtë dhuratë të bankës. Ndjeshmëria e Intesa Sanpaolo Bank Albania ndaj këtij komuniteti i bashkohet përpjekjeve të Grupit Intesa Sanpaolo në dhënien e kontributit për mbrojtjen e mjedisit, shëndetit, punës, të ardhmes, mirëqenies të të gjithë komunitetit si dhe mbrojtjen e sistemit të marrëdhënieve sociale.



## PROCREDIT BANK

ProCredit Bank mbështeti “Konferencën e dytë shkencore të studentëve të Universitetit Bujqësor të Tiranës” e zhvilluar në muajin Qershor, që pati për qëllim nxitjen e mëtejshme të kërkimeve dhe punimeve shkencore nga ana e studentëve.

Në vazhdim të aktiviteteve, banka ka organizuar takime të hapura me studentë në qytetin e Tiranës dhe Durrësit. Në takimin e zhvilluar më 5 shtator, pranë zyrave qendrore të ProCredit Bank, pjesëmarrësit u informuan rreth programit “Bankierët e Rinj”, si një hap i rëndësishëm në edukimin e mëtejshëm të studentëve në botën e sistemit bankar por njëkohësisht edhe si një proces trajnimi dhe sfidash drejt hapit të suksesit për t’u punësuar pranë Bankës ProCredit. Kandidatët potencialë për programin Bankierët e Rinj janë individë që kanë eksperiencë pune, studentë që diplomohen ose janë diplomuar rishtazi, pavarësisht nga fusha e tyre e studimit, dhe që duan të zhvillohen profesionalisht në një bankë etike dhe të përgjegjshme.





## RAIFFEISEN BANK

*Raiffeisen Bank sponsorizon rikonstrukcionin e shëtitores dhe të qendrës së informimit turistik në Gjirokastrë.*

Raiffeisen Bank në bashkëpunim me Bashkinë e Gjirokastrës, mundësoi rikonstrukcionin e shëtitores kryesore në sheshin "Çerçiz Topulli", si dhe të qendrës së informimit turistik. Këto dy projekte erdhën në momentin e pikut të sezonit, kur qindra turistë të huaj dhe vendas vizitojnë qytetin e bukur të Gjirokastrës i cili është i përfshirë në listën botërore të trashëgimisë së UNESCO-s që nga 15 Korriku i vitit 2005.

Ceremonia e përrurimit të këtyre rikonstrukcioneve u mbajt në kuadrin e një sërë aktiviteteve të organizuara nga Bashkia Gjirokastrë me rastin e 8-vjetorit të hyrjes së Gjirokastrës në UNESCO. Në ceremoni ishin të pranishëm kryetari i Bashkisë së qytetit, z. Flamur Bime, dhe drejtori i Përgjithshëm i Raiffeisen Bank, z. Christian Canacaris. Z. Canacaris u shpreh se ndihej shumë i lumtur për prerjen e shiritit dhe për kontributin në përmirësimin e jetesës së qytetarëve të Gjirokastrës.

*Z. Christian Canacaris, drejtor i Përgjithshëm i Raiffeisen Bank merr titullin "Qytetar Nderi" i qytetit të Gjirokastrës*

Me rastin e aktiviteteve për 8-vjetorin e hyrjes së Gjirokastrës në UNESCO, Bashkia e Gjirokastrës organizoi një ceremoni në Kalanë e qytetit, gjatë të cilës z. Christian Canacaris, iu dha titulli "Qytetar Nderi" i Gjirokastrës me motivacionin: "Për kontribut të shquar dhe mbështetje të vazhdueshme në zhvillimin e projekteve infrastrukturore e ambientale në qytetin e Gjirokastrës dhe shërbime të vlerësuara sociale e publike për komunitetin".

Ky titull i atribuohet Raiffeisen Bank, e cila ka qenë e pranishme pothuaj në të gjithë sektorët: arsim, shëndetësi, kulturë e turizëm të qytetit të Gjirokastrës, tha z. Canacaris gjatë fjalës së tij.

*Raiffeisen Bank sponsorizon rikonstrukcionin e pishinave në qytetin e Sarandës*

Raiffeisen Bank, në kuadër të bashkëpunimit me bashkinë e këtij qyteti, sponsorizoi rikonstrukcionin e pishinave të qytetit. Në ceremoninë e përrurimit ishin të pranishëm: kryetari i Bashkisë, z. Stefan Çipa, dhe drejtori i Përgjithshëm i Raiffeisen Bank z. Canacaris, i cili pas prerjes së shiritit u shpreh se: "...shpresoj që noti, një sport i dashur dhe i shëndetshëm, një traditë në këtë qytet, do të gjallërohet tani me këtë pishinë dhe shumë talente do të dalin nga Saranda."



## TIRANA BANK

*Tirana Bank mundëson Koncertin Recital për Violinë dhe Violonçel*

Tirana Bank përfaqëson artet për të mbështetur artistët dhe instrumentistët e rinj të muzikës klasike: në bashkëpunim me orkestrën simfonike të Radio Televizionit Shqiptar, ajo mundësoi më 28 qershor koncertin recital për violinë dhe violonçel. Pjesë të përzgjedhura me kujdes, të kompozitorëve më të njohur të epokës së Romantizmit, si: Çaikovski dhe Brahms, u luajtën në hollin veror "Gjon Simoni" të Radio Tiranës. Ato u sollën plot emocion nga violinistja Nevila Dergjini dhe violonçelisti Andi Alimemaj, nën drejtimin e dirigjentit të mirënjohur Gridi Kraja.



## VENETO BANKA

*Veneto Banka mbështet ekipin kombëtar shqiptar të Beach Volley*

Në datat 16-18 gusht 2013 u zhvillua Kampionati Ballkanik i Beach Volley për të Reja. Veneto Banka ishte suporti zyrtar i ekipit kombëtar të Shqipërisë U-20, që u përfaqësua denjësisht në këtë kampionat, duke fituar medaljen e bronzit, pasi fitoi në gjysmëfinale në një ndeshje shumë të fortë kundër Turqisë. Veneto Banka vjen në këtë eveniment ndërkombëtar pas eksperiencave të ngjashme të mbështetjes së ekipeve të "UMB Volley" dhe "Himara Volley".

*Veneto Banka në plazhet shqiptare*

Projekti "Summer Tour 2013", i organizuar nga stafi i pedagogëve dhe studentëve të Universitetit "Marin Barleti", gjatë muajve të verës kishte si qëllim nismën "për një mjedis turistik të pastër". Veneto Banka mbështeti këtë projekt dhe ishte prezent kudo me materiale promocionale në kuadrin e një përgjegjëshmërie sociale për mjedis jo vetëm të pastër por dhe tërheqës.



•Kredi •Depozita •Biznes  
•Transferta



**KEMI FITUAR QETESINE ME**



**UBA**

## PROGRAMI EDUKATIV MË I NJOHUR NË BOTË PËR EDUKIMIN E TË RINJVE MBI SIPËRMARRJEN, JUNIOR ACHIEVEMENT®, TANI EDHE NË SHQIPËRI, FALË MBËSHTETJES SË FONDACIONIT SHQIPTARO-AMERIKAN PËR ZHVILLIM (AADF).



**Rezarta Godo**  
Drejtor Ekzekutiv, Junior Achievement of Albania



**Studentët**  
Junior Achievement of Albania

**C**ila është organizata Junior Achievement of Albania?

Junior Achievement of Albania, një organizatë jofitimprurëse e themeluar në vitin 2012, është përgjegjëse për zbatimin e programit me të njëjtin emër, Junior Achievement® (JA) në shkollat e mesme të Shqipërisë.

**Qëllimi ynë është të fuqizojmë të rinjtë shqiptarë për të qenë të suksesshëm në jetë dhe në punë, si dhe për të qenë ekonomikisht të pavarur.**

Programi JA është një program edukativ i iniciuar fillimisht në vitin 1919 në Shtetet e Bashkuara të Amerikës me synim nxitjen e punësimit të të rinjve amerikanë dhe aftësimin të tyre për punë. Ndër vite ky program u zhvillua dhe u pasurua në përmbajtje dhe larmishmëri sipas zhvillimit dhe dinamikës së tregut të punës, sistemit ekonomik dhe revolucionit teknologjik. Sot, programi JA ofron njohuri praktike dhe bashkëkohore të rinjve në 122 shtete të botës. Në rrejetin ndërkombëtar të Junior Achievement përfshihen 402.815 vullnetarë nga bota e biznesit, 312.954 mësues dhe 10.1 milion nxënës çdo vit.

Aktualisht, programi Junior Achievement® (JA) zbatohet në shkollën e mesme, i integruar në kurrikulën zyrtare, si lëndë me zgjedhje të lirë. Programi ofrohet në klasë të 11-të dhe në klasë të 12-të. Në klasë të 11-të, janë integruar 2 module të programit Junior Achievement: "Etika e biznesit"

dhe "Aftësi për sukses", ndërsa në klasë të 12-të janë integruar 3 module të programit: "Shoqëritë sipërmarrëse të nxënësve", "Drejtues për një ditë" dhe "Bëhu sipërmarrës".

*Cili është roli i vullnetarëve të biznesit?*

Përfshirja e vullnetarit nga sektori i biznesit në klasë është një praktikë mbarë botërore e JA. Vullnetari konsiderohet si shtylla kurrizore e programit.

Përfshirja e biznesit në programin JA ndodh në disa nivele:

- a) si vullnetarë biznesi në klasë;
- b) si drejtues dhe profesionistë të mirëfilltë që shoqërohen nga një nxënës përgjatë një dite pune, në kuadër të aktivitetit kombëtar të përvitshëm "Drejtues për një ditë";
- c) si mbështetës të të rinjve duke kontribuar në aktivitetet JA, si anëtarë jurie dhe vlerësues të talenteve të reja.

Vullnetarët e biznesit në klasë vepronë si mentorë dhe si shembuj model për nxënësit e programit JA.

Konkretisht, vullnetarët mbështesin një klasë JA përgjatë 1 viti akademik (4-8 orë në muaj), duke këshilluar nxënësit përgjatë procesit të zhvillimit të lëndës/lëndëve JA, duke orientuar nxënësit drejt vendimeve të duhura apo strategjive të duhura menaxheriale, si dhe duke kanalizuar energjitë e tyre kreative drejt sipërmarrjeve inovative.

Gjithashtu, vullnetarët e biznesit sjellin në klasë shembuj realë nga tregu i punës, ndajnë përshtypje dhe eksperiencën nga bota e biznesit, si dhe ofrojnë ekspertizë dhe profesionalizëm.

Roli dhe impakti i vullnetarëve të biznesit mbart një rëndësi madhore për nxënësit shqiptarë, të cilët gjejnë frymëzimin, sigurinë, vetëbesimin dhe kurajon për të ndërmarre nisma të guximshme sipërmarrëse, si dhe për t'u përgatitur për tregun e punës.

**Ftojme kandidatë potencialë, individë apo korporata në Tiranë dhe në rrethe, të interesuar për rolin e vullnetarit të biznesit të përcjellin shprehje interesi dhe jetëshkrimin e tyre në adresën e postës elektronike [vullnetari@junior-achievement.org](mailto:vullnetari@junior-achievement.org).**

**Lëndët sipas Junior Achievement**

**Gjatë këtij viti akademik 2013–2014, programi Junior Achievement do të zbatohet në 100 shkolla të mesme të vendit, i përfshirë në kurrikulën zyrtare si lëndë më zgjedhje të lirë në:**

**Klasë të 11-të:** Njohuri për Biznesin I, sipas Junior Achievement (1 orë në javë, 36 orë në vit). Në këtë lëndë integrohen dy module "Etika e biznesit" dhe "Aftësi për sukses"

**Klasë të 12-të:** Njohuri për Biznesin II, sipas Junior Achievement (34 orë në vit). Në këtë lëndë integrohen 3 module "Shoqëritë e nxënësve", "Bëhu sipërmarrës", "Drejtues për një ditë"

## LAJME NDËRBALLKANIKE

## BOSNJE - HERCEGOVINË



**Banka Qendrore e Bosnjës dhe agjencitë bankare nënshkruajnë udhëzimet për përgatitjen e provave të rezistencës dhe përdorimin e instrumenteve prudenciale**

*Balkans.com - 08.07.2013*

Banka Qendrore e Bosnjë-Hercegovinës (CBBH), Agjencia Bankare e Federatës dhe Agjencia Bankare e Republika Srpska nënshkruan udhëzimet për përgatitjen e provave të rezistencës dhe përdorimin e instrumenteve prudenciale, në takimin e Komitetit të Koordinimit të Mbikëqyrjes Bankare, të mbajtur në 19 mars 2013. Qëllimi i dokumentit është zyrtarizimi i përgatitjes së provave të rezistencës, si dhe përcaktimi i detyrimeve dhe përgjegjësisë të Bankës Qendrore dhe agjencive bankare në procesin e zbatimit të provave të rezistencës dhe përcaktimit të marrëdhënieve midis monitorimit makroprudencial, mbikëqyrjes së vazhdueshme dhe procesit të menaxhimit dhe minimizimit të rreziqeve.

**IFC dhe Sberbank bashkëpunojnë për zgjerimin e tregtisë në Bosnjë - Hercegovinë**

*Balkans.com - 12.09.2013*

IFC-ja, i ka ofruar një hua për qëllime tregtie Sberbank-ut, me qëllim kanalizimin e financimeve të mëtejshme të klientët e bankës, që angazhohen në veprimtarinë e import - eksportit në Bosnjë - Hercegovinë. Me një linjë huaje prej 20 milionë US\$, Sberbank-u do të rrisë ofertat e produkteve të saj dhe mbështetjen financiare për klientët korporativë në Bosnjë - Hercegovinë që angazhohen në tregtinë ndërkombëtare, duke i ndihmuar kështu këto firma të hyjnë në tregje të reja, të zgjerojnë veprimtarinë e tyre dhe të krijojnë vende të reja pune.

## BULLGARIA



**BDB do të mbulojë gjysmën e rreziqeve për huat që bankat tregtare u japin NVM-ve**

*Balkans.com - 27.08.2013*

Fondi Kombëtar i Garancisë (NGF), pjesë e Bankës së Zhvillimit të Bullgarisë (BDB), lançoi një program të ri garancish, i cili synon të mbulojë gjysmën e rreziqeve për huat që bankat tregtare do t'u japin ndërmarrjeve të vogla e të mesme (NVM). Kjo nismë konsiston në një fond prej 360 milionë levash. Programi i ri synon të lehtësojë qasjen në

burimet e financimit dhe kryerjen e veprimtarisë tregtare, nëpërmjet lehtësimit të kërkesave për kolateral në Bullgari. NVM-të mund të aplikojnë për financim pranë bankave tregtare dhe këto të fundit do të përfitojnë garanci huash nga NGF-ja.

**Cibank përfiton 50 milionë euro për të financuar NVM-të në Bullgari**

*Balkans.com - 30.09.2013*

Banka Europiane e Investimeve (EIB) i akordon një hua prej 50 milionë eurosh CIBANK-ut me qëllim financimin e projekteve që promovohen nga ndërmarrjet e mesme dhe të vogla si dhe ato me kapitalizim të mesëm në Bullgari. Fondet e EIB-së do të mbështesin projektet në të gjithë vendin, me objektiv madhor rritjen e punësimit. Kjo hua e ndërmjetësuar akordohet në kuadër të Planit të Përbashkët të Veprimit të IFN-së për Rritje në Europën Qendrore dhe Juglindore, që përqendrohet në sigurimin e qasje më të shpejta në sigurimin e financimeve afatgjata për NVM-të Europiane, me qëllim minimizimin e efekteve të krizës financiare.

## GREQIA



**Depozitat bankare tkurren me 178 milionë euro**

*Balkans.com - 05.09.2013*

Sipas të dhënave të Bankës së Greqisë, depozitat bankare u zvogëluan me 178 milionë euro në gusht, duke i çuar në total kursimet e ekonomive familjare dhe bizneseve në 162 miliardë euro. Në të njëjtën kohë, huadhënia vijon të tkurret, në një normë 3.9 %, duke e çuar totalin e huave të marra nga sektori privat në 221.8 miliardë euro, nga 222.4 miliardë euro që ishte në korrik. Rrjedha neto e financimit të bizneseve dhe ekonomive familjare ishte negativ, pasi shlyerjet e huave tejkaluan huatë e akorduara me 823 milionë euro. Kjo ka çuar në shtrëngesë likuiditeti të bankave, të cilat si pasojë nuk mund të japin më shumë hua.

**Rreth 7.5 miliardë euro nga fondet e BE-së do të injektohen në ekonominë e Greqisë gjatë vitit tjetër**

*Balkans.com - 27.09.2013*

Një sasi e konsiderueshme fondesh të Bashkimit Europian - që arrin në 7.5 miliardë euro - do të kanalizohen drejt ekonomisë greke gjatë vitit të ardhshëm, pohoi Ministri i Zhvillimit z. Costis Hatzidakis në Bruksel. Ky projekt i referohet financimeve të periudhës aktuale (2007-13), me vlerë 3.5 miliardë euro, sikurse dhe projekteve të mbyllura, që nuk u përfshinë në këtë program, por që do të përfshihen në programin e ri të financimit për periudhën 2014-20, me synim absorbimin e menjëhershëm të fondeve. Rreth 4 miliardë euro fonde të BE-së pritet të injektohen në ekonominë e vendit deri në fund të vitit.

## KOSOVA



### Kosova fillon përpunimin e pagesave elektronike për skemat sociale

25.07.2013

Banka Qendrore e Republikës së Kosovës filloi, për herë të parë, përpunimin, bartjen, transferimin dhe shlyerjen përfundimtare të rreth 153 mijë transaksioneve të pagesave, për katër skema sociale të Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale (MPMS), përmes Skemës së Pagesave Masive të Sistemit Elektronik të Kleringut Ndërbankar (SEKN). Ky proces karakterizohet nga një standardizim dhe automatizim i lartë i mënyrës së pagesës, duke qenë një proces i shpejtë, i lehtë dhe i sigurt.

### Themelohet Grupi Kombëtar i Anëtarëve dhe Përdoruesve të SWIFT-it në Kosovë

30.08.2013

Pas njohjes së Republikës së Kosovës nga ana e SWIFT-it, Banka Qendrore e Republikës së Kosovës dhe bankat tregtare themeluan Grupin Kombëtar të Anëtarëve dhe Përdoruesve të SWIFT-it në Kosovë, që njihet si Grupi SWIFT i Kosovës. Ky grup kombëtar do t'u sigurojë të gjitha institucioneve anëtare përfaqësimit e interesave karshi SWIFT-it, cilësi të lartë të shërbimeve dhe qasje në informacione të përshtatshme lidhur me SWIFT-in, si dhe do të lehtësojë formimin e opinionit të përbashkët.

## KROACIA



### Huat në valutë të huaj nuk do jenë me rrezik për bankat

FriedlNews - 05.08.2013

Rreth 100,000 huamarrës në Kroaci kanë marrë gjatë periudhës 2000 - 2008, hua në valuta të huaja. Pas vitit 2008, pagesat e interesave u rritën papritur. Gjatë pranverës, Gjykata Tregtare e Kroacisë vendosi që bankat nuk i kanë informuar siç duhet klientët e tyre, lidhur me këto hua. Për rrjedhojë, bankat nuk e kanë përmbyshur rolin e tyre dhe tashmë janë të detyruara të kompensojnë këta klientë. Sipas Gjykatës Tregtare, bankat duhet, brenda 60 ditëve, t'i konvertojnë huat në monedhën vendase. Kursi i këmbimit do të jetë ai i ditës së nënshkrimit të kontratës së huas. Për më tepër, norma e interesit do të vendoset *ex post*. Vendimi nuk ka ende fuqi ligjore.

### Kroacia parashikon që deficitin buxhetor të arrijë në 5.5% të GDP-së në vitin 2014

Balkans.com - 27.09.2013

Shpenzimet në rritje për pagesat e interesave dhe për anëtarësinë e Kroacisë në Bashkimin Europian gjatë vitit 2014 do të çojnë në rritjen e deficitit buxhetor me rreth 8 miliardë kuna, ku shpenzimet e përgjithshme priten të arrijnë në 131.7 miliardë kuna dhe deficitin buxhetor në 17.4

miliardë kuna, ose 5.5 % të GDP-së së vitit tjetër, pohoi Ministri i Financave, z. Slavko Linic, gjatë një takimi qeveritar në Zagreb. Linic paralajmëroi se në vitin 2014, kostot për interesa të borxhit publik aktual do të rriten me 2.5 miliardë kuna, ndërkohë që kostot e anëtarësimin në BE do të arrijnë në 4.7 miliardë kuna.

## MALI I ZI



### Mali i Zi merr hua 60 milionë euro nga Deutsche Bank, Erste për të mbuluar garancitë e huave të KAP

SeeNews - 15.07.2013

Mali i Zi siguroi një hua 60 milionë euro (78.2 milionë US\$) nga Deutsche Bank dhe Erste Bank, për financimin e detyrimeve që rrjedhin nga aktivizimi i garancive të dhëna nga shteti për një hua të uzinës lokale të shkrirjes së aluminit KAP. Huaja trevjeçare e Malit të Zi ka një periudhë mospagimi prej 18 muajsh me një normë vjetore interesi fikse prej 6.42%. Një gjykatë në Podgoricë ka nisur në fillim të muajit procedurat e falimentimit ndaj shoqërisë KAP që po del me humbje.

### Axhustimi i sistemit bankar të Malit të Zi është në një fazë të avancuar pas një tkurrjeje masive

Balkans.com - 04.09.2013

Rimëkëmbja e Malit të Zi nga kolapsi prej bumit të huadhënies në vitin 2008 u ngadalësua nga problematika e borxheve të sektorit privat. Autoritetet ndërmorën një rregullim të konsiderueshëm fiskale në vitin 2012, por niveli i borxhit vijoi të rritet, duke arritur në 52% në fund të vitit. Axhustimi i sistemit bankar në Malin e Zi është në një fazë të avancuar pas një tkurrjeje masive, pas plasjes së flluskës së huadhënies, por bankat vazhdojnë të përballen me një stok të lartë të huave me probleme. Bankat kanë shitur në mënyrë agresive një pjesë të këtyre huave te shoqëritë e faktoringut, por këto të fundit kanë lëvizur ngadalë me shlyerjen apo ristrukturimin e këtyre aktiveve me probleme, duke lënë bilancet e shoqërive private ende me probleme.

## MAQEDONIA



### Banka Qendrore Maqedonase me praktika "pranë ose plotësisht" sipas standardeve të BE-së në shumë fusha

Balkans.com - 11.07.2013

Banka Qendrore Evropiane dhe Banka Kombëtare e Maqedonisë (NBRM) përfunduan një program bashkëpunimi, për t'u bashkuar Sistemit Europian të Bankave Qendrore (ESCB), pasi vendi të aderojë në BE. Raporti i analizimit të nevojave konkludon se NBRM-ja tashmë ka praktika dhe politika që janë të njëjta ose të

përafërta me standardet e BE-së në shumë fusha, si dhe paraqet rekomandime për përmirësime të mëtejshme, veçanërisht në ato fusha ku progresi duhet bërë përparim, në drejtim të arritjes së standardeve të BE-së.

### IFC dhe Banka Ohridska e Maqedonisë bashkëpunojnë për të zgjeruar qasjen në financime

*Balkans.com - 23.08.2013*

IFC-ja dhe Ohridska Banka filluan bashkëpunimin për të zgjeruar qasjen në financime dhe për të nxitur tregtinë ndërkombëtare midis bizneseve të vogla në Maqedoni. IFC-ja akordoi një linjë kredie tregtare prej 10 milionë US\$ për Ohridska Banka, si pjesë e Programit të Financimit të Tregtisë Globale. Me mbështetjen e IFC-së, Ohridska Banka do të ketë mundësi të ofrojë financime shtesë për klientët e saj, veçanërisht për ndërmarrjet e vogla dhe të mesme me potencial rritje, që janë aktivë në sektorët e energjisë, metalurgjisë, minierat, tekstilit, përpunimit të ushqimeve dhe transportit.

### RUMANIA



### Rumania, sipas sondazheve, do të ulë normën bazë gjatë Takimit të Tretë

*nga Irina Savu - 2.09.2013*

Sipas 14 nga 18 ekonomistët e pyetura nga një sondazh i Bloomberg-ut, Banka Kombëtare e Rumanisë do të ulë normën bazë në 4.25% nga 4.50%. Politikëbërësit, që e mbajtën koston e huamarrjes të pandryshuar për më shumë se një vit pas një rritje të inflacionit, rifilluan uljen e kësaj norme në korrik, pasi rritja e indeksit të çmimit të konsumit këtë muaj u ngadalësua brenda objektimit të tyre prej 1.5 - 3.5%. Banka qendrore shkurtoi kostot e huamarrjes me rreth 75 pikë bazë në korrik dhe gusht, pasi ndaloi zvogëlimin e saj në marsin e kaluar.

### Rumania planifikon të grumbullojë të paktën 1 miliard euro nga edicioni i dytë i obligacioneve

*Balkans.com - 06.09.2013*

Rumania planifikon të grumbullojë të paktën 1 miliard euro nga edicioni i dytë i emetimit të obligacioneve këtë vit, një lëvizje kjo për të mbuluar deficitin e saj buxhetor. Vendi synon të grumbullojë 2.5 miliardë euro në tregjet ndërkombëtare këtë vit, me emetimin në vlerë 1,5 miliardë dollarë, me një yield të ulët prej 4.5%, në muajin shkurt. Yield-i i euroobligacioneve të Rumanisë me maturim në vitin 2019 u rrit dje me dy pikë bazë në 4.16%, nga niveli minimal prej 3.4% në muajin maj.

### SERBIA



### NMV-të si forca shtytëse e zhvillimit ekonomik

*Balkans.com - 02.09.2013*

Zëvendëskryeministri dhe Ministri i Tregtisë së

Brendshme e të jashtme dhe Telekomunikacioneve të Serbisë, z. Rasim Ljajic pohoi se NMV-të janë forca shtytëse e zhvillimit ekonomik dhe baza e rritjes së GDP dhe uljes së normës së papunësisë. Gjatë hapjes së Panairit të 14<sup>te</sup> të novacionit, bashkëpunimit dhe sipërmarrjes "Inokoop", në Zrenjanin, z. Ljajic theksoi se sektori privat në Serbi punëson sot 45% të të gjithë numrit total të punonjësve dhe kontribuon me 30% të totalit të GDP-së.

### Serbia mund të ulë normën bazë të interesit pas rënies së inflacionit

*09.09.2013*

Banka Qendrore e Serbisë mund të ulë normën bazë të interesit, pasi i mbajti të pandryshuara për dy muaj kostot e huamarrjes, si pasojë e uljes së ritmit të rritjes së indeksit të çmimeve të konsumit dhe dobësimit të dinarit në nivelin më të ulët të tij në 11 muaj. Sipas një sondazhi të Bloomberg, 11 nga 24 ekonomistët mendohet se Banka Kombëtare e Serbisë do të ulë normën njëjavore të riblerjes në 10.75% nga 11%.

### TURQIA



Stamboll



### Turqia ka qenë e imunizuar nga kriza ekonomike - Banka Botërore

*Balkans.com - 13.09.2013*

Ekonomia turke do të përshtatet ndaj ndryshimit të kushteve të ekonomisë globale, siç rezultoi nga vendimi i fundit i Bankës së Rezervës Federale të SHBA-ve (Fed), për të përfunduar procesin disavjeçar të zgjerimit të likuiditetit, tha drejtori i Bankës Botërore për Turqinë, Martin Raiser, duke folur në Forumin Ndërkombëtar të Sistemeve Financiare. Turqia do të përshtatet lehtësisht me rrethanat në ndryshim të ekonomisë globale. Turqia u rrit me 4.4% në tremujorin e dytë të vitit, rritje që ishte më e lartë se ç'pritej.

### Banka qendrore mban të pandryshuar normat e interesit me një qëndrim "të kujdesshëm"

*Balkans.com - 19.09.2013*

Banka qendrore e Turqisë, vendosi në 17 shtator të mbajë të pandryshuara tre normat kryesore të interesit, ndërsa kërkon të gjejë një rrugë të mesme midis rritjes së nivelit të monedhës (lirës) së dëmtuar dhe ruajtjes së ritmit të rritjes së ekonomisë, përpara një sërë zgjedhjesh kritike. Banka Qendrore e Republikës së Turqisë (BQRT) e mbajti normën referencë të marrëveshjeve të riblerjes njëjavore në nivelin 4.5%. Normat njëditore të huadhënies dhe huamarrjes, që shënojnë kufirin e sipërm dhe kufirin e poshtëm të korridorit të normave të interesit, u mbajtën përkatësisht në nivelet 7.75% dhe 3.5%.

## WINBANK - GJITHÇKA NË NJË KUTI



**nga Zj. Frida KRIFCA<sup>1</sup>**  
Menaxhere e Departamentit  
të Marketingut dhe PR  
Tirana Bank

Me rritjen dhe përhapjen e madhe të përdorimit të internetit, klientët e bankave po i riorientojnë preferencat e tyre për shërbimet bankare, nga ato tradicionale drejt kanaleve alternative, kryesisht drejt bankingut online. Ky ndryshim po fiton përditë më shumë terren e po bëhet realitet në Shqipëri, ku shumica e popullsisë tani ka qasje në internet. Kanalet alternative u ofrojnë klientëve një gamë të plotë të shërbimeve, kryesisht të njëjta me ato të ofruara nëpërmjet degëve tradicionale. Për shumë arsye, që lidhen me komoditetin dhe/ose kontrollin e shërbimeve, përdorimi i kanaleve alternative, të tilla si: shërbimet bankare online dhe aplikacioneve nëpërmjet celularit pritet të shndërrohen gradualisht në kanal kryesor, që konsumatorët do të zgjedhin për kryerjen e transaksioneve bankare.

Angazhimi i Tirana Bank për t'u ofruar klientëve të saj mundësinë e zgjedhjes prej një seri kanalesh alternative, u bë realitet në vitin 2012, kur Tirana Bank Online, u bë pjesë e markës së suksesshme, e me shumë çmime të fituara, winbank, që tashmë njihet dhe si winbank Web Banking. winbank është divizioni i bankingut elektronik i Bankës së Pireut, përgjegjës i kanaleve alternative të bankës, si: winbank web

Këto shërbime bankare ofrohen me një qëllim të vetëm, mbështetjen e përhershme të klientëve, duke i shtuar vlerë kohës së tyre, mbështetur në jetën e përditshme, sidomos në biznesin e tyre.

Banking, winbank Mobile Banking, winbank Phone Banking dhe winbank për Kartat e Kreditit. Përdorimi i platformës elektronike winbank u krijon mundësinë klientëve të kryejnë transaksione të plota bankare 24 orë në ditë, gjatë 7 ditëve të javës, duke e bërë më të lehtë jetën e klientëve, e për më tepër, këto janë shërbime të ofruara falas.

Platforma winbank është vlerësuar me shumë çmime e medalje. Shërbimi bankar në celular i Bankës së Pireut është shpallur, si: "Bankingu më i mirë me celular" në Europë, për të dytin vit. Për më tepër, shërbimi bankar në internet i Bankës së Pireut është vlerësuar, si: "Dizajni më i mirë i

faqes së internetit" në Europë, po ashtu edhe Banka e Pireut në Qipro. Shërbimi bankar në internet u shpall, si: "Faqja e internetit më e integruar për konsumatorët" në Europë. Gjithashtu, shërbimi bankar në internet i Bankës së Pireut u vlerësua, edhe për këtë vit në Greqi, si: "Banka në internet më e mirë për klientët", i njëjti çmim që u fitua edhe nga Banka e Pireut në Qipro.

Shërbimet e ofruara nga winbank kanë evoluar krah për krah me tregun e shërbimeve bankare në internet. Fushat kryesore, në të cilat winbank po punon vazhdimisht për të ruajtur përparësinë e saj konkurruese janë përdorimi i thjeshtë dhe komoditeti, funksionaliteti dhe natyrisht, siguria. winbank ofron shkallën më të lartë të komoditetit të përdorimit dhe u mundëson klientëve të përdorin shërbimet bankare, gjatë gjithë kohës dhe në çdo vend. Kjo platformë u jep mundësinë klientëve të kryejnë çdo lloj transaksioni bankar, vetëm me një klikim dhe nëpërmjet çdo mjeti tjetër komunikimi. Tashmë përdorimi i internetit, si një kanal alternativ i ri për shpërndarjen e shërbimeve financiare, është bërë një domosdoshmëri konkurruese dhe jo vetëm një mënyrë për të arritur përparësi konkurruese, si pasojë e globalizimit dhe konkurrencës. Kjo është arsyeja pse përveç lehtësisë së përdorimit të informacioneve dhe shërbimeve nga klientët me të gjitha mjetet e komunikimit, winbank punon vazhdimisht në ruajtjen e cilësisë së lartë të shërbimit në lidhje me përdorimin e teknologjisë, duke ofruar shërbime dhe aplikacione të ndryshme. winbank, së bashku me një rrjet të gjerë të ATM-ve të Tirana Bank, u mundëson të gjithë klientëve

WINBANK ofron shkallën më të lartë të komoditetit të përdorimit dhe u mundëson klientëve të përdorin shërbimet bankare, gjatë gjithë kohës dhe në çdo vend. Kjo platformë u jep mundësinë klientëve të kryejnë çdo lloj transaksioni bankar, vetëm me një klikim dhe nëpërmjet çdo mjeti tjetër komunikimi.

<sup>1</sup> Zj. Frida KRIFCA e ka mbajtur këtë pozicion deri në datë 30.09.2013; pas kësaj date ajo është larguar në një pozicion tjetër jashtë Tirana Bank.

# Prezenca gjeografike, Veneto Banka sh.a



## DREJTORIA E PËRGJITHSHME:

Blvd. "Dëshmorët e Kombit"  
Kullat Binjake, Kati i Dytë  
Tel. +355 (0) 42 280 555  
Fax. +355 (0) 42 280 356  
E-mail: info@venetobanka.al  
www.venetobanka.al

## TIRANA 1

Blvd. "Dëshmorët e Kombit"  
Kullat Binjake, Kati i Dytë  
Tel. +355 (0) 42 280 555  
Fax. +355 (0) 42 280 356

## TIRANA 2

Blvd. "Zogu I",  
Stacioni i Trenit  
Tel. +355 (0) 42 259 351  
Fax. +355 (0) 42 259 350

## TIRANA 3

Kashar - Mëzez,  
Autostrada Tiranë - Durrës, Km.3  
Tel. +355 (0) 42 407 331  
Fax. +355 (0) 42 407 330

## TIRANA 5

"Rruga e Kavajës",  
Poliambulanca Italiane  
Tel. +355 (0) 42 274 944/7  
Fax. +355 (0) 42 228 636

## TIRANA 6

Rr. "Sulejman Delvina",  
Stadiumi "Dinamo"  
Tel. +355 (0) 42 274 501/2  
Fax. +355 (0) 42 203 555

## TIRANA 7

Rruga e Kavajës,  
përballë Minibashkisë Nr. 6,  
Sheshi Qëndror i Kombinait

## ELBASAN

Lgji. "Emin Matraxhiu"  
Rr. "Kamber Sejdimi",  
Tel. +355 (0) 54 242 245/6  
Fax. +355 (0) 54 246 318

## DURRËS 1

Qendra e Biznesit "EGT"  
Sheshi pranë Bashkisë  
Tel. +355 (0) 52 229 331  
Fax. +355 (0) 52 229 331

## DURRËS 2

Lgji. 14, ish - NSHMN-ja  
Kompania "Pespa", Shkozë

## VLORË

Blvd. "Vlorë - Skelë",  
tek ish fabrikes se Orizit  
Tel. +355 (0) 33 230 888  
Fax. +355 (0) 33 230 888

## FIER

Sheshi " Fitorja",  
Rr. "Jakov Xoxa"  
Tel. +355 (0) 34 231 876  
Fax. +355 (0) 34 231 877

## SHKODËR

Rruga "Studenti",  
tek Radio "Shkodra"  
Tel. +355 (0) 22 250 288  
Fax. +355 (0) 22 250 288

## LEZHE

Lgji. " Besëlidhja",  
Rr. "Hydajet Lezha"  
Tel. +355 (0) 21 524 066  
Fax. +355 (0) 21 524 062

## KAVAJË

Lgji. "Nr. 1", "Murrizi 2009"  
Tel. +355 (0) 55 247 407  
Fax. 0355 (0) 55 245 202

## KORÇË

Bulevardi "Cjergj Kastrioti",  
ish - Hotel "Turizmi"  
Tel. +355 (0) 82 257 401  
Fax. +355 (0) 82 257 861



- **WINBANK WEB BANKING** – Banka nëpërmjet kompjuterit tuaj personal (PC / Mac), duke përdorur cilindo shfletues
- **WINBANK MOBILE BANKING** – mundëson kryerjen e veprimeve bankare nëpërmjet celularit
- **WINBANK MOBILE APPS** – nëpërmjet shkarkimit të aplikacionit winbank Mobile Albania, nga Android, IOS, mund të kryhen transaksione bankare, ndërkohë që klienti është në lëvizje. Klienti i regjistruar në winbank Web Banking, mund të përdorë drejtpërdrejt ID-në ose PIN-in e tij/saj, për të aksesuar aplikacionin
- **WINBANK PHONE BANKING** – një shërbim ku klienti mund të kryejë transaksione të sigurta bankare 24 orë në ditë gjatë 7 ditëve të javës, si dhe komunikon drejtpërdrejt me një agjent, për të kryer transaksionet e tij/saj.
- **WINBANK PËR KARTAT** – klienti "lidhet" me kartat e kreditit dhe sheh të gjitha detajet në lidhje me to, në çdo kohë të ditës, pa ndonjë nevojë për regjistrim paraprak.
- **SINJALIZUESI WINBANK PËR KARTAT E KREDITIT** – klienti informohet menjëherë dhe vazhdimisht, ndërkohë që shërbimi parandalon mashtrimet me kartat e kreditit, duke aktivizuar sinjalizuesin e alarmit të sigurisë. Ky shërbim i njofton klientët menjëherë në e-mail-in e tyre dhe/ose me një sms në celular, për blerjet dhe tërheqjet "cash" që kryejnë me kartën e kreditit, çdo herë që shtypet fatura mujore e kartës së kreditit dhe çdo herë që karta do të rriemtohet apo zëvendësohet.

e saj kryerjen e të gjitha shërbimeve të tyre bankare në çdo kohë, pa pasur nevojë të presin në radhë, ose të jenë të pranishëm në degët e saj. Gjithash-tu, bashkë me winbank vijnë edhe aplikacione të ndryshme, si: shërbimi i lokalizuesit të ATM-së, nëpërmjet të cilit mund të lokalizohet ATM-ja/ dega më e afërt.

Privatësia dhe siguria janë dimensionet e rëndësishme që mund të ndikojnë në vendimin e klientëve për të përdorur transaksionet dhe shërbimet në internet. Megjithatë, winbank ofron teknologjinë dhe platformën e saj, për të kapërcyer shqetësimet e klientëve të saj rreth këtyre çështjeve. Përmes infrastrukturës së saj, winbank siguron transaksione të sigurta dhe të besueshme financiare. Hyrja në servera kontrollon nga "firewall"


të veçantë, të cilët u lejojnë klientëve akses në shërbime të veçanta dhe refuzojnë hyrjen e tyre në sistemet e bazave të të dhënave me informacione të klasifikuara bankare. Veç kësaj, nga fillimi deri në fund të lidhjes me platformën elektronike winbank, të gjitha të dhënat personale janë koduar me protokollin "encryption".

Me funksionalitetin e platformës elektronike winbank transaksionet janë të sigurta dhe të garantuara. Nëse faqja winbank mbetet e papërdorur për shtatë minuta, sistemi të nxjerr automatikisht jashtë. Kjo platformë ofron gjithashtu "extra PIN", që është një kod shtesë i detyrueshëm, që përdoret për të ekzekutuar pagesat ndaj palëve të treta, dërgesa si dhe transaksione të tjera monetare. Për më tepër, për arsye sigurie, mund të

përdoren dy nivele autorizimesh, sipas kërkesës së klientëve. Nëpërmjet winbank, klienti mund zgjedhë llogaritë të cilat nuk dëshirojnë të ketë akses nëpërmjet winbank internet, celular, SMS dhe telefon. winbank zotëron gjithë të dhënat dhe software-ët e duhur për të ekzekutuar transaksione të sigurta. Klientët nuk duhet të blejnë software shtesë, të ruajnë të dhënat në kompjuterin e tyre, të krijojnë një kopje rezervë të tyre apo të presin për përditësimin e software-ve ose versioneve të reja.

Dizajni cilësor, grafika dhe ngjyrat, por dhe prirja për të portretizuar imazhin e mirë të bankës, rrisin përdorimin efikas të këtyre platformave. winbank ofron një dizajn estetik dhe kjo e bën platformën vizualisht tërheqëse dhe lehtësisht të përdoshme. Dizajni i winbank është vlerësuar, si: "Dizajni më i mirë i faqes së internetit" në Europë, duke rritur lehtësinë e përdorimit të saj dhe përmbush kënaqësinë e konsumatorëve.

Cilësia e shërbimit në industrinë e shërbimit bankar në internet është e rëndësishme, pasi bashkëveprimi njeri - internet është kanali kryesor i komunikimit. Ofrimi i shërbimeve me cilësi të lartë për të kënaqur nevojat e klientëve, është një tjetër përparësi konkurruese e winbank. Winbank siguron transaksione të shpejta brenda llogarive bankare të Tirana Bank dhe Grupit Bankar të Pireut dhe më e rëndësishmja, në llogaritë e bankave të ndryshme kombëtare dhe ndërkombëtare. Shërbimet e ofruara nga winbank ndihmojnë jo vetëm klientët individë, por edhe bizneset. Shërbimet e lartpërmendura rrisin konkurrueshmërinë e biznesit, por edhe efikasitetin e kohës së çdo klienti të bankës. Shërbimet elektronike bankare janë mjete shumë të rëndësishme që mund të rrisin përvojën e konsumatorit. Koha bëhet më e vlefshme në shoqërinë e sotme, duke i kursyer kohën klientit, për të mos shkuar në një nga degët e bankës dhe ndërkohë i ofron atij qasje në llogari dhe shërbim bankar 24 orë, për 7 ditë të javës. Tirana Bank është e përkushtuar për të mbështetur dhe përmirësuar shërbimet elektronike bankare të saj dhe do të vazhdojë të investojë në ofrimin e shërbimeve dhe produkteve të reja për klientët. Shërbimet bankare ofrohen me një qëllim të vetëm, që është: të gjendurit gjithmonë përkrah klientëve, duke i shtuar vlerë kohës së tyre dhe mbështetur në jetën e përditshme, sidomos në biznesin e tyre.



# TITULLIZIMI – NJË MEKANIZËM REVOLUCIONAR PËR MENAXHIMIN DHE TRANSFERIMIN E RREZIKUT

Titullizimi mund të përdoret nga një institucion financiar për të menaxhuar një larmi të madhe rreziqesh, si: rreziqet e normave të interesit, rrezikun e parapagimit, rrezikun e besueshmërisë dhe rrezikun e likuiditetit. Gjithashtu, titullizimi mund të shihet si një armë strategjike për penetrim në treg dhe për diversifikim.

Kohë më parë, banka ka qenë një veprimtari biznesi e thjeshtë. Banka huazonte fonde likuide nga të tretët dhe u jepte hua të tretëve me një marzh shtesë mbi koston e fondeve. Aktiviteti i huamarrjes dhe huadhënies pasqyrohet në bilancin e bankës. Por tashmë bankat me shumë gjasa e ushtrojnë këtë veprimtari sa “jashtë bilancit”, ashtu dhe “brenda bilancit”.

Për shembull, kur banka shet një angazhim huaje, ajo është e detyruar të sigurojë dhe ofrojë fondet, vetëm nëse klienti e ushtron këtë angazhim. Nëse klienti i “tërheq” fondet, atëherë huaja do të paraqitet në bilanc. Megjithatë bankat mund ta shmangin financimin, madje që në këtë fazë, duke e shitur huanë te një bankë tjetër, ose duke e titullizuar atë. Titullizimi përfshin gërshetimin e huave me karakteristika të ngjashme, duke krijuar pretendime me besueshmëri të rritur, ndaj rrjedhave të parasë së këtij portofoli huash, e më tej shitjen e këtyre pretendimeve te investuesit.

Praktika e shitjeve të huave nga banka është mjaft e vjetër: ajo daton që në vitin 1880. Nga ana tjetër, titullizimi është shumë më i vonshëm, e daton në vitin 1970, kur Shoqata Qeveritare e Huave Hipotekore Kombëtare (GNMA) – Ginnie Mae, zhvilloi letrën me vlerë me pagesa të transferueshme, një lloj titulli i mbështetur nga huat hipotekore.

Bankat janë “lojtarë” të pranishëm relativisht vonë në këtë treg. Edhe pse në vitin 1977 Bank of America emtoi të parën letër me vlerë me pagesa të transferueshme të sektorit privat, mbështetur nga huat hipotekore, titullizimi i llojeve të ndryshme të huave bankare nuk filloi para vitit 1985.

Titullizimi mund të përdoret nga një institucion financiar për të menaxhuar një larmi të madhe rreziqesh, si: rreziqet e normave të interesit, rrezikun e parapagimit, rrezikun e besueshmërisë dhe rrezikun e likuiditetit. Gjithashtu, titullizimi mund të shihet si një armë strategjike për penetrim në treg dhe për diversifikim.

## Llojet e ndryshme të kontratave të titullizimit

Letrat me vlerë që mbështeten nga huat, zakonisht mbështeten nga huat hipotekore rezidenciale, dhe ato tregtare, huat për automobila, detyrimet e pagueshme nga kartat e kreditit, qiratë për pajisjet kompjuterike dhe kamionat, huat për shtëpi të lëvizshme, si dhe detyrimet e ndryshme financiare. Ekzistojnë tri lloje bazë letrash me vlerë të mbështetura në aktive, të cilat janë zhvilluar nga tregu dytësor hipotekor.


### 1. Letrat me vlerë të transferueshme

Lloji i parë i letrave me vlerë të mbështetura nga huat, janë letrat me vlerë me pagesa të transferueshme (*pass-through*), që përfaqësojnë një

zotërim të drejtpërdrejtë në një portofol huash hipotekore, me karakteristika të ngjashme për sa i përket afatit të maturimit, normës së interesit dhe cilësisë së huas. Portofoli i transferohet një subjekti të besuar, apo mekanizmi për qëllime të veçanta (*Special Purpose Vehicle, SPV*) dhe certifikatat e pronësisë shiten drejtpërdrejt te investuesit; çdo certifikatë përfaqëson një pretendim kundrejt gjithë portofolit të huas. Origjinuesi i huas (p.sh.: një bankë ose institucion kursimesh) siguron mbarëvajtjen e portofolit të huave dhe grumbullon interesin dhe kryegjënë nga huat, megjithëse shpesh origjinimi dhe mbarëvajtja kryhen nga institucione të ndryshme. Mbarëvajtësi i portofolit, nga të ardhurat e mbledhura, zbrit një tarifë të caktuar shërbimi dhe e transferon diferencën te investuesit, prej nga rrjedh dhe emri “letra me vlerë me pagesa të transferueshme”. Pronësia mbi huat (hipotekat) i kalon zotëruesve të certifikatave. Kështu, letrat me vlerë me pagesa të transferueshme nuk paraqiten në bilancin e origjinuesit të huave. Këto letra me vlerë përdorin dy struktura; paketën statike dhe atë dinamike, të cilat do të diskutohen më poshtë.

### 2. Obligacionet e mbështetura nga aktivet

Lloji i dytë i letrave me vlerë të mbështetura nga aktivet janë obligacionet e mbështetura nga aktivet



(*asset-backed bonds, ABB*). Sikundër dhe letrat me vlerë me pagesa të transferueshme me strukturë statike, ABB-të kolateralizohen (mbështeten) nga një portofol huash. Dallimi kryesor është se, në rastin e ABB-ve, origjinuesi i shet aktivet te një filial që zotërohet tërësisht prej tij, i krijuar me qëllimin e vetëm për të titullizuar aktivet. Rrjedhimisht, aktivet mbeten në bilancin (e konsoliduar) të origjinuesit. Me pak fjalë, në vend që të shiten aktivet te një SPV, e cila në vijim shet (emeton) pretendime kundrejt aktiveve të origjinuesit, është vetë filiali që i emeton këto pretendime (nota të detyrimeve të përgjithshme) te investuesit. Këto pretendime janë të garantuara vetëm nga aktivet e filialit, apo nga cilado rritje (mbështetje) besueshmërie që merret për këtë qëllim. Figura e mësipërme paraqet strukturën e rrjedhës së parash, në rastin e një ABB-je. Siç tregohet dhe në figurë, shoqëria financiare, që është filial i zotëruar tërësisht prej origjinuesit, emeton certifikatat/notat te investuesit, zakonisht nëpërmjet një banke investimi që nënshkruan edicionin e emetimit. Të ardhurat që arkëtohen nga shoqëria financiare prej pagesave të kryegjësë dhe interesit transferohen në një shoqëri kujdestare. Këto të ardhura shtohen te kontributet në fonde likuide që paguan enti që an-

gazhohen në rritjen e besueshmërisë së edicionit të ABB-ve, e më tej, këto fonde disbursohen për investuesit nga shoqëria kujdestare.

### 3. Letra me vlerë me pagesa të përcaktuara (Pay-throughs)

Lloji i tretë i ABS-ve është obligacioni me pagesa të përcaktuara (*pay-through bonds*). Kjo letër me vlerë kombinon tiparet e letrës me vlerë me pagesa të transferueshme dhe ato të ABB-së. Ngjashmëria me ABB-në konsiston në atë letra me vlerë me pagesa të përcaktuara, paraqitet si borxh në bilancin e origjinuesit. Ngjashmëria me letrat me vlerë me pagesa të transferueshme është se rrjedhat e parave, që burojnë nga paketa e aktiveve të përdorura si kolateral, shkojnë për detyrimet që rrjedhin nga obligacionet.

### 4. Risitë e procesit të titullizimit

Në treg vijojnë të prezantohen lloje të reja të kontratave të titullizimit dhe kjo për tri arsye kryesore. Së pari, normat e ulta të interesit i kanë bërë më të vlefshme për investuesit opsionet e parapagimit të huave hipotekore, të cilët në kthim janë bërë më të sofistikuar, në trajtimin e rrezikut të parapagimit. Kështu, krijohen letra me vlerë të reja, që lehtësojnë menaxhimin e rrezikut të parapagimit.

Së dyti, investuesit që janë relativisht të painformuar në lidhje me shpërndarjet probabilitare të pagesave të ardhshme të letrave të ndryshme me vlerë, e gjejnë veten në pozitë jo të favorshme në raport me investuesit, që janë relativisht më të mirëinformuar. Kështu, investuesi i painformuar do të kërkojë letra me vlerë që janë relativisht të pandjeshme ndaj informacionit, duke i copëzuar rrjedhat e parave që gjenerohen nga një letër me vlerë e përbërë dhe e ndjeshme ndaj informacionit, në mënyrë të tillë që letra me vlerë e rangut më të lartë të jetë thuajse e çliruar nga rreziku, duke u bërë kështu shumë tërheqëse për investuesit e painformuar.

Së treti, risitë në procesin e titullizimit dhe copëzimin e rrjedhave të parave ka lehtësuar gjithashtu dhe krijimin e letrave me vlerë, që janë tërheqëse për investuesit e informuar. Një letër me vlerë e caktuar, që përmban disa të dhëna jopublike, mund të copëzohet gjithnjë në dy letra me vlerë, ku njëra prej të cilave është më e ndjeshme ndaj informacionit (ka një përmbajtje më të madhe të të dhënave jopublike), sesa letra me vlerë bazë (originale).

**Përgatiti stafi i AAB-së**

